



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0798

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo” me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, më 20.10.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., me nr. 2025/0798, e datës 20.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo”, me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL.
2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL për aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo”, me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.10.2024 MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo” me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 1.200.000.00€.

Me 05.08.2025 MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), për aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo” me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1, ku është rekomanduar për kontratë grupin e OE “Mburoya shpk & Samire Osmani; N.SH.H Zona Park; Vlorë A. Ahmeti B.I; Efa Dienstleistung GmbH dega në Kosovë.

Me 08.08.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 13.08.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.08.2025, OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0798, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

1ANKESË PRANË OSHP Lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe Hemorragjike Krime -Kongo ” Nr. prokurimi: 203 -24-10403 -2-1-1 Autoriteti Kontraktues – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Nga: Grupi i Operatorëve Ekonomik : • Doctor Exterminator DDD SH.P.K. • Ekologjia SH.P.K. • Truly Nolen SH.P.K. DISPOZITAT E SHKELURA SIPAS LPP -së 1. Neni 1 – Qëllimi 2. Neni 2 – Fushëveprimi 3. Neni 4 – Përkufizimet 1.75 Konfliktet e Interesit 4. Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 5. Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo -Diskriminimi 6. Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve 7. Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës 8. Neni 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve 9. Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale 10. Neni 130 - Ndikimi i Paligjshëm Rregullorja e Prokurimit Publik 001/2022 (Versioni i Konsoliduar) 11. Neni 99 Masat disiplinore për shkeljet të rënda 12. Neni 16 Regjistri përmbledhës i prokurimit pika h. Deklarata nën betim të anëtarëve të komisionit

vlerësue s 13. Neni 97 pika b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; 14. Neni 97 pika d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të percaktuar me LPP . Shkeljet e parimeve themelore për fshijnë, vendosjen e kriterëve apo dëshmive jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njesisë së kërkuar . 15. Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 01/2019 -UA KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS 16. Neni 395 Legalizimi i përmbajtjes së rreme 17. Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 18. Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik 2 Grupi ynë i operatorëve ekonomikë, në cilësinë e pjesëmarrësve në aktivitetin e mësipërm të prokurimit, paraqet këtë ankesë me arsyetimin kundër vendimi të Autoritetit Kontraktues Ministria e Buj qësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për eliminimin e ofertës së onë dhe rekomandimin për shpalljen fitues të GOE “MBUROYA SH.P.K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë” e cila është marrë në kundërshtim të rëndë me ligjin e LPP ,Regulloren,dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës , Ku do të bashkangjesim argumentet dhe faktet konkrete të shkeljeve në këtë procedurë tenderuese . Kjo ankesë mbështetet në fakte e pakontestuar dhe të dokumentuara, shkelje të qarta procedurale dhe ligjore, si dhe në analiza të drejtpërdrejta të dokumentacionit të ofertës së GOE-ve të rekomanduar për dhënje të kontratës, të cilat dëshmojnë qartë mosplotësimin e kushteve thelbësore të Dosjes së Tenderit. Pasi që AK nuk i merr për bazë asnjë nga faktet e parashtruara duke i pasur të gjitha dokumentet e GOE të rekomanduar për kontratë, ne do t’ju paraqesim në mënyrë të detajuar dhe kronologjike të gjitha faktet, shkeljet, manipulimet, keqinterpretimet, korrespondenca e e-maileve ndërmjet ZP, KV dhe Njesisë kërkuar dhe GOE , legalizimi i përmbajtjes së rreme dhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare nga AK . Përgjigjet nga AK: AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e parë (1) të datës: 13.08.2025 : OE ankues tenton të shtrembërojë dhe të krijojë konfuzion përmes shkresave duke cituar fillimisht se licenca për ekologë është e paligjshme, diskriminuese dhe e fabrikuar. Sqarojmë se ky pretendim është i pabazuar pasi që AK asnjëherë nuk ka pas qëllim diskriminimin as favorizimin e asnjë OE. Ju vet keni kërkuar edhe informata shpesh në lidhje me dosjen e tenderit me datë 03.11.2024 dhe me datë 13.11.2024 keni pranuar përgjigjen nga AK por as ju edhe asnjë OE tjetër nuk ka cekur që një licencë e tillë nuk ekziston. Të gjithë OE kanë pasur mundësi e ankesës sipas – Neni 108/A paragrafi 2 përcakton se çdo ankesë për kushtet dhe kriteret e DT -së duhet të bëhet para afatit të dorëzimit të ofertave. Në këtë rast, asnjë GOE e as ju nuk e keni ushtruar këtë të drejtë, prandaj pretendimi është i ligjërshët i papranueshëm seps e në Dosja e Tenderit është paraparë që eksperti Ekolog duhet të posedojë licencë (referuar nenit 59.4 të LPP -së, ku thuhet se: “Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë kriteret e kualifikimit pas publikimit të njoftimit për kontratë”) dhe komisioni ka vlerësuar në bazë të kriterëve të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu lidhur me këtë situatë GOE të rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarime të detajuara me datën 25.05.2025 për ekspertin në fjalë. Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar. 3 I. Shkelje të rëndë të ligjit nga Autoriteti Kontraktues – Kërkesa për “licencë profesionale ” për ekologun është e paligjshme, diskriminuese dhe qëllimisht e fabrikuar për eliminim të një OE -je të përgjegjshme me cmimin më të lirë. Një nga akte më skandaloze dhe të paprecedentë të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i tij i Vlerësimit është eliminimi i ofertës së Grupit tonë për mungesën e një dokumenti të cilin as ligji nuk e njeh, as shteti nuk e ofron, dhe asnjë institucion publike nuk e lëshon – të ashtuquajturës “licencë profesionale ” për profesionin ekolog . Kjo kërkesë është e rreme, e paligjshme dhe tendencioze , e bërë në mënyrë të qëllimshme për të gjetur pretekste për eliminimin e një operatori ekonomik serioz dhe të përgjegjshëm. Në mënyrë krejtësisht të

paligjshme , AK ka shpikur një kusht që nuk figuron në asnjë akt ligjor apo nënligjor në Republikën e Kosovës dhe që është mohuar zyrtarisht nga vetë institucionet kompetente se një licencë e tillë nuk egziston! Ne kemi pas hëkëngjitur dëshmi nga institucionet relevante të rks: Dokument zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë – Bordi i Licencimit , nënshkruar nga znj. Igballe Buzoku -Marovci, ku thuhet qartë se: “Profili Ekologji nuk është pjesë e regjistrimit zyrtar të profesionistëve e shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë e marratur nga Ministri i Shëndetësisë me datë 19.09.2024 me nr protokoli 05 - 7246.” . Bashkangjitur e kemi vërtetimin. 4 5

Komunikim i përmes emailit zyrtar nga z. Abdullah Pirce , drejtor për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, i cili gjitha shtu konfirmon se nuk ekziston ndonjë organ shtetëror që lëshon “licencë profesionale ” për profesionin ekolog. Pavarësisht këtyre provave, Autoriteti Kontraktues jo vetëm që i ka injoruar faktet dhe dokumentet zyrtare , por ka shkuar më tej duke na eliminuar si të papërgjegjshëm në këtë bazë, ndërkohë që Grupi I Operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë janë vlerësuar të përgjegjshëm duke ofruar një “licencë për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) ”, e cila është një autori i vetëm për një shërbim krejtësisht tjetër dhe nuk dëshmon për kualifikimet individuale apo profesionale të një ekologu . Ky dokument nuk ka asnjë lidhje me kualifikimet profesionale individuale të një ekologu dhe nuk dëshmon aspak që individ z. Pajtim Bytyqi që e posedon është EKOLOG I LICENSUAR për identifikimin dhe kontrollin e vektorëve biologjik si rriqërat dhe kontrollin e popullatës së tyre , sepse një licencë e tillë thjesht nuk ekziston sipas ligjit . Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708> Megjithatë, AK ka eliminuar ofertën tonë dhe ka pranuar si të vlefshme një “licencë për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) ”, e cila lidhet me aktivitete industriale (ndërtim, miniera, industri kimike, energjetike, transport masiv, etj.) sipas Ligjit Nr. 08/L -181 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2017. Ky dokument nuk ka asnjë lidhje me profesionin e ekologut dhe nuk është i aplikueshëm për shërbimin e prokuruar – dezinfektimin e hapësirave për Ethe Hemorragjike Krime -Kongo – i cili nuk është aktivitet i nënshtruar procedurave të VNM. Për më tepër, udhëzimi ADMINISTRATIV për licencim VMN ndalon që një person i punësuar në një kompani të hartojë raporte VN M për të njëjtën kompani, gjë që është shkelur nga OE “Mburoya ” me z. Pajtim Bytyqi. Kjo përbën konflikt të pastër interesi dhe bën të pavlefshme licencën e ofruar. 6 AK në refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim në përgjigjen e pretendimit nr. 2 citojmë: Gjithashtu lidhur me këtë situatë GOE të rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarime të detajuara me datën 25.05.2025 për ekspertin në fjalë. Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar. Sipas AK dhe OE dokumenti i ofruar me këtë datë e përmbush kriterin për licencim të Ekologut bie në kundërshtim drejtëpërdrejtë me MMPHI me qenëse se kjo Ministri nuk lëshon licencë për EKOLOG. Ndërsa OE ofron një dokument të lëshuar nga MMPHI e cila merret me hartimin e raporteve të VNM -së por asesi si licencë profesionale . Siç është e konfirmuar nga vetë kjo Ministri (MMPHI). 7 8 Andaj KV dhe ZP shkelin me vetëdije të plotë deklaratën nën betim , Rregulloren e Prokurimit Publik, Neni 16 Regjistri përmbledhës i prokurimit pika h. Deklarata nën betim të anëtarëve të komisionit të vlerësues. Shkelje e barazisë në trajtim (neni 7 i LPP -së), Neni 130 - Ndikimi i Paligjshëm KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS Neni 395 Legalizimi i përmbajtjes së rreme , Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar , Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik Përdorim i kriterëve joekzistues për eliminim selektiv të ofertuesve , dhe Keqinterpretim i qëllimshëm i ligjit me qëllim të shpërblimit të ofertuesve të preferuar . Prandaj, kërkojmë që kjo pikë të rrëzohet si e pavlefshme , të anulohet vlerësimi diskriminues dhe në kundërshtim me LPP , RRPP dhe KODI PENAL I REPUBLIKËS së Kosovës , dhe të rivendoset e drejta dhe barazia për të gjithë operatorët ekonomikë, pa kriterë fiktive dhe pa vendime arbitrare që favorizojnë një palë e dëmtoj në palën tjetër . Pas ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumentet e prokurimit dhe komunikimet zyrtare ndërmjet

njesisë kërkuese dhe komisionit vlerësues, janë siguruar prova të reja të pa kontestueshme që hedhin poshtë plotësisht pretendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me ekzistencën e një “kërkese për licencë profesionale të ekologut ” si kusht kualifikimi. E-MAILET E KOMUNIKIMIT ZYRTAR ME NJËSINË KËRKUESE JANË PROVA QË NUK KËRKOHEJ ASNJË “LICENCË EKOLOGU ” Kërkesa pabazuar dhe fiktive e kërkesës për “licencë profesionale ” për ekologun konfirmohet dhe zhbëhet plotësisht përmes një dëshmie të re zyrtare, të pakontestueshme dhe të dorëzuar nga vetë njësia kërkuese, përkatësisht nga Isuf Cikaqi Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregjeve në MBPZHR të hartuar dhe dërguar tek ZP me shkresë zyrtare të datës 03.09.2024 me nr . protok olli 3293, me nr. të referencës: 04 -425/24. NË EMAILIN ZYRTAR E DËRGUAR ME DATË 16 KORRIK 2025, NGA Z. ISUF CIKAQI, SI NJËSI KËRKUESE DHE PËRGJEGJËS PËR HARTIMIN E KRITEREVE, DËRGUAR KOMISIONIT TË VLERËSIMIT, CITOHEJ SAKTËSISHT: “...askund nuk e kemi paraqitur kërkesën e as nuk e kemi parapar/kërkuar që eksperti profesional – Ekologu të jetë i paisur me licencë ...” Ai shton më tej: “...Ne kemi paraparë dhe kemi i kërkuar vetëm për Operatorin Ekonomik që duhet të posedoj leje/licencë për këtë lloj veprimtarie ...” Të bashkangjitur e keni e -mailin zyrtar të njesisë kërkuese z. Isuf Cikaqi 9 Kjo prov ë e pakontestueshme nga autoriteti (njësia kërkuese) që e ka hartuar v etë dosjen e tenderit, rrëzon përfundimisht çdo legjitimitet të pretendimit të AK -së për eliminimin e ofertës sonë mbi bazën e mungesës së një “licence të ekologut ”, e cila: 1. Nuk është kërkuar nga njësia kërkuese, 2. Dhe nuk ekziston në sistemin ligjor dhe institucional të Republikës së Kosovës. Veprim i i AK-së për të interpretuar në mënyrë të gabuar një kriter që nuk figuron askund në dokumentet zyrtare, dhe për më tepër për ta përdorur atë si arsye eliminimi, është i papranueshëm, në kundërshtim me nenin 7, nenin 59.4, nenin 60, dhe parimin e sigurisë juridike dhe transparencës që përshkon të gjithë Ligjin për Prokurimin Publik. 10 Përfundimisht, përjashtimi i ofertës sonë mbi këtë bazë është jo vetëm i paligjshëm, por i fabrikuar dhe diskriminues, dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues duhet të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm . II. Shkelje e rëndë procedurale dhe KEQPËRDORIM I DETYRËS ZYRTARE – Eliminimi pa kërkesë për sqarim shtesë sipas nenit 59 të LPP -së përbën veprim të qëllimshëm për eliminim të ofertës sonë më të lirë të përgjegjshme . Shih Dëshminë e raportit të fundit të Vlersimit , ku shihet qartë në faqen 17 tek Inormata shtesë mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit nga GOE Doctor Exterminator DDD SHPK, EKOLOGJIA SHPK & TRULY NOLEN SHPK , nuk janë kërkuar sqarime shtesë. AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e parë (1) të datës: 13.08.2025 : Ju keni dorëzuar kontratën e punës me orar të rregullt për z. Murtez Kurtaj, cila përmbush kriteret e nenit 9.1 & 9.2 për Kapacitetin teknik dhe Profesional në DT. Neni 59 i LPP -së parasheh se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime vetëm nëse dokumentacioni është i paqartë ose i paplotë. Në këtë rast, dokumenti ka qenë i qartë dhe nuk ka pasur nevojë për sqarim shtesë. Autoriteti Kontraktues, përmes Zyrës së Prokurimit dhe në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues, ka kryer një shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik, konkretisht të nenit 59, si dhe një keqpërdorim të pozitës zyrtare në kuptim të nenit 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ”). Eliminimi i menjëhershëm i ofertës së Grupit tonë të Operatorëve Ekonomikë është bërë mbi bazën e një “mangësie ” e cila nuk e prek thelbin e ofertës, është e lehtësisht e sqarueshme dhe mund të dokumentohet plotësisht në rrugë zyrtare. Ky veprim i padrejtë jo vetëm që cenon parimet e ligjshmërisë dhe transparencës, por edhe dëmton interesin publik, pasi i mbron buxhetit të Kosovës kursimin e mjeteve financiare përmes ofertës sonë me çmim më të ulët saktësisht 191,100.00€ më lirë . 11 Parimi themelor i prokurimit publik është që kontrata të jepet ofertës e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë , ndërsa në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke mos ofruar as mundësinë minimale të sqarimit sipas

nenit 59 të LPP . I njeiti parim do të duhej të vlente dhe për të gjithë OE në garë, por që një kërkesë e tillë nuk ka vlejtur për të gjith OE por selektivisht dhe me qëllime diskriminuese vetëm ndaj nesh si GOE. Kjo shpije tek d yshimi i bazuar se Komisioni i Vlerësues në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit dhe akterët tjerë janë dakorduar me dashje dhe vetëdije të propozojnë të shpëblejnë me kontratë GOE të papërgjegjshëm me çmim 971,100.00€ duke keqpëdorur detyrën zyrtare dhe shkelur Kodin penal të Republikës së Kosovës Neni 414 . Nëse AK do të kishte ndjekur detyrimet e veta ligjore, oferta jonë e cila është e përgjegjshme, konkurruese , jo vetëm që nuk do të duhej të eliminohej, por do të vlerësohej si oferta më të favorshme ekonomikisht me çmim më të lirë 780,000.00€ . Për këtë arsye, mbajtja në fuqi e këtij vendimi jo vetëm që është e papranueshme juridikisht, por përbën precedent të rrezikshëm për të gjitha aktivitetet e ardhshme të prokurimit në Republikën e Kosovës. Kjo është një thirrje e drejtpërdrejtë për përgjegjësi, hetim dhe anulim të vendimit të paligjshëm. Në dokumentacionin e ofertës tonë është dorëzuar një kontratë e vitit 2020 , në të cilën z. Kurtaj figuron si i punësuar me status primar në kompaninë Ekologjia SH.P .K . Megjithatë, kjo kontratë është e tejkaluar, pasi që nga 01.04. 2022, z. Kurtaj është i punësuar me orar të jo-plotë dhe i regjistruar në ATK me status sekondar . Ju bashkangjesim raportin e të punësuarëve në kompaninë EKOLOGJIA të vitit 2022 ku, shihet qartë se në muajin e parë dmth 01/2022 z. Murtez Kurtaj është i punësuar si PRIMAR ndërsa në muajin 04/2022 i njeiti kalon si i punësuar SEKONDAR. Ky është një fakt që rezulton lehtësisht nga verifikimi i të dhënave në sistemin zyrtar të ATK -së. 12 Në vend që të kërkojë kërkohej sqarim shtesë sipas nenit 59 , që do të ishte rruga e më e lehtë dhe ligjërish e domosdoshme në një rast kur paraqitet një dokument i tejkaluar teknikisht . 13 AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e dytë (2) të datës: 13.08.2025 : Përgjigje për pretendimin e dytë Në përputhje me nenin 59 – “Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderit ”, ju njoftojmë se Komisioni vlerësues është themeluar ng a Autoriteti Kontraktues. Të gjithë anëtarët e komisionit kanë marrë përgjegjësi në vlerësimin e tyre duke respektuar kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin e kontratës. Pas përgatitimit të punës së komisionit ka konstatuar se oferta e rekomanduar për kontratë është plotësisht e përgjegjshme dhe përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe ofertat çmimore me të lirë se buxheti i parashikuar. Andaj pretendimi juaj është i pa bazuar. Në përgjigjen e dhënë, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar vetëm me një deklaram të përgjithshme se “Komisioni ka respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit ” dhe se oferta e rekomanduar për kontratë i ka përmbushur të gjitha kërkesat. Ky formulim është i paarg umentuar dhe nuk adreson në asnjë pikë thelbin e pretendimit tonë, i cili lidhet me faktin se gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, Komisioni ka bërë devijime të dukshme nga kriteret e përcaktuara në DT, duke legjitimuar par regullsi që cenojnë konkurrencën e barabartë dhe integritetin e procedurës. Në vend që të paraqesë prova konkrete se si nuk janë përmbushur kërkesat e DT -së për secilin operator ekonomik të rekomanduar për kontratë , AK është fshehur pas një justifikimi fo rmal, duke shmangur transparencën e nevojshme . Ky veprim bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 7 dhe nenin 59 të LPP -së, ku kërkohej qartësisht që çdo vendim të mbështetet në arsye dhe prova të dokumentuara. Pa këtë mbështetje, deklarata e AK -së mbetet thjesht një pohim i njëanshëm, i cili nuk e kundërshton dot asnjë prej argumenteve tona. Më tej, AK nuk ka dhënë asnjë s pjegim pse janë anashkaluar elementë të tillë si: mospërputhja e dokumenteve me kërkesat teknike , kër kesat profesionale , kapacitetet financiare, stafin profesional, metodologjinë e punës, përdorimi i licencave jo të përshtatshme për profilin e kërkuar apo pranimi i dokumenteve të pasakta , të rreme, ose fiktive të cilat ne i kemi evi dentuar dhe prezentuara tek ZP në mënyrë të qartë. Arsyeja e dhënë nga Autoriteti Kontraktues, se OE i rekomanduar për kontratë është më i lirë se buxheti i parashikuar, përbën një justifikim të kamufluar dhe tërësisht absurd. Në fakt, oferta jonë është plotë 420,000.00 € më

e lirë se buxheti i planifikuar, duke e bërë këtë arsytim jo vetëm të pabazë por edhe kontradiktor. Pas ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumentet të Raportit të Vlersimit dhe në ofertat e Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në këtë aktivitet prokurimi, Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë ka realizuar një vlerësim të thelluar dhe të strukturuar të dokumentacionit të 14 operatorëve ekonomik fitues me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së tyre me kërkesat teknike dhe ligjore të për caktuara në Dosjen e Tenderit. Ky vlerësim ka rezultuar me mangësi serioze dhe të pakontestueshme , të cilat jo vetëm ne si operator , por edhe Komisioni i Vlersimit i përbërë nga Kryesuesi i Komisionit Sami Osmani dhe anëtarët Arnesa Ferizi dhe Kasum Morina dëshmojnë se asnjëri nga këta operatorë nuk i përmbush kushtet minimale të kualifikimit dhe të kapacitetit teknik e profesional , përkundër faktit që me vendimin e ri çuditërisht janë rekomanduar për kontratë. Katër raporte, dy narrativa: fillimisht të shp allur fitues dhe të përgjegjshëm GOE Doctor Exterminator DDD SHPK, EKOLOGJIA SHPK & TRULY NOLEN SHPK , më pas të eliminuar nga komisione të ndryshme . E gjithë struktura e vlerësimit të këtij aktiviteti prokurimi është shndërruar në një proces tërësisht të k ompromentuar dhe të udhëhequr nga qëllimi për të shpërblyer operatorë të caktuar, përkundër fakteve objektive dhe përkundër përmbajtjes së dokumenteve të ofruara nga operatorët. Ky devijim është lehtësisht i dokumentueshëm përmes katër raporteve zyrtare të komisioneve të vlerësimit , të cilat ndryshojnë nga njëra -tjetra në mënyrë drastike dhe të pajustificueshme – pa ndonjë fakt të ri, pa ndonjë ndryshim në përmbajtje dhe pa asnjë bazë juridike apo metodologjike. 23.01.2025 Raporti i parë – Vlerësim profesio nal dhe korrekt , por i ndikuar nga mashtrimi i GOE “MBUROYA SH.P.K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë ” Përbërja: Arsim Memaj – Kryesues Arizona Dibra – Anëtare Leutrim Prokshi – Anëtar Në këtë raport të parë, komisioni i ka trajtuar të gjitha ofertat në mënyrë objektive dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit. Si GOE jonë, ashtu edhe GOE -të tjerë, janë vlerësuar si të përgjegjshëm, ndërsa ne jemi shpërblyer me kontratë për shkak të ç mimit më të ulët, në përputhje me kriterin Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Megjithatë, duhet theksuar se GOE “MBUROYA SH.P.K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë ”, në mënyrë të qëllimshme, kanë paraqitur kontrata të natyrave jo të fushës DDD Dhe dezinfektimit hapsinorë , por si kontrata për furnizim me mjete higjienike, mirëmbajtje objektesh, furnizim me tunel dezinfektues, apo kontrata të përziera me pjesëmarrje në konsorcium e, të cilat: 15 ? Nuk janë kontrata të përfunduara individualisht, ? Nuk janë shërbime të D.D.D. -së dhe dezinfektimit hapsinorë siç kërkohet në kërkesa 9.2, ? Dhe në shumë raste janë të ri-përsëritura apo të mbivendosura për periudha të njëjta. Kjo ka ndikuar që komisioni të mendojë gabimisht se operatorët përmbushnin pragun e kërkuar prej 950,000.00 €, duke i dhënë atyre vlerësim të përgjegjshëm. Pra, pavarësisht se raporti ka qenë në thelb korrekt në vlerësimin tonë si fitues legjitim, operatorët e tjerë kanë mashtruar komisionin përmes paraqitjes së dokumentacionit të pavlefshëm, të stërp ërsëritur dhe të qëllimshëm të paqartë, me qëllim që të shtrembërojnë realitetin financiar dhe teknk dhe profesional t ë tyre 03.06.2025 Raporti i dytë – Komision i ri, narrativë e re Përbërja : Lulzim Shamolli – Kryesues Elheme Hetemi – Anëtare Arsim Memaj – Anëtar Ky komision i ri, ndonëse përfshin një nga anëtarët e parë, ndryshon në mënyrë të pashpjegueshme qëndrimin profesional të komisionit të parë. Këtu, GOE Mburoya SHPK, Samire Osmani B.I., N.SH.H ZONA PARK, VLORA AHMETI B.I. EFA DIENSTLEINSTUNG GMBH – Dega në Kosovë janë vlerësuar si të papërgjegjshëm për kërkesën dëshmi të kënaqshme se ka realizuar me sukses kontratanë lëminë e DDD -së dhe Dezinfektimit Hapësinor në vlerë 950,000 .00 €, pasi kanë paraqitur kontrata vetëm në vlerë prej 569,590.58 € . Në këtë raport, dy nga tre anëtarët (Arsim Memaj dhe Elheme Hetemi) kanë dhënë qëndrimin e tyre pro shpalljes së ofer tës së GOE Doctor Exterminator , EKOLOGJIA

SHPK, TRULY NOLEN SHPK . si më e suksesshme , duke u bazuar në çmimin më të ulët dhe dokumentacionin e plotësuar në përputhje me kriteret. Përkundër këtij votimi, kryesuesi i komisionit, Lulzim Shamolli , ka qenë kundër , pa dhënë argumente të mbështetura në ligj apo në ndonjë mungesë reale në dokumentacion. Pavarësisht faktit se dy vota pro përbëjnë mazhorancën e thjeshtë , raporti është përfunduar me përfundimin absurd se “nuk ka pasur konsensus” . Ky veprim përbën shkelje të rëndë të Nenit 39 pika 39.7 dhe parimit të shumicës në proceset kolegjiale dhe tregon një ndërhyrje të qartë të zyrtarëve të lartë në MBPZHR për të sabotuar qëllimisht një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Përdorimi i termit “mungesë konsensusi” është një justifikim i fabrikimit të vendimit, me qëllim të vetëm: pengimin e shpalljes fitues të ofertës sonë që të o frojmë shërbimet për paran dalimin dhe kontrollin në zonat e infestuara me rriqëra e me këtë kanë parandaluar mbrojtjen e shëndetit publik të asaj zone gjegjësisht ky keqinterpretim i konsensusit është keqpërdorë për krijimin e bazës për të shpallur fitues palët e parapëlqyera që ja në komplet të papërgjegjshëm. 16 Të bashkangjitur raporti i dytë i vlerësimit 01.07.2025 Raporti i tretë – Komisioni tjetër, eliminimi i mbështetura pa fakte dhe pa argumente. Përbërja : Sami Osmani – Kryetar Arnesa Ferizi – Anëtare Kasum Morina – Anëtar Ky raport vjen pas kërkesës sonë për rishqyrtim , e aprovuar si pjesërisht e bazuar nga AK. Edhe në këtë rast, dokumentet e Samire Osmani B.I. nuk janë marrë parasysh (për shkak të statusit si biznes i shuar), dhe shuma e vlerës totale të përvojës së operatorëve të tjerë mbetet po ajo: 569,590.58 € – shumë që sërish nuk përmbush kërkesën për dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata në lëminë e D.D.D. dhe Dezinsektim hapësinor në vlerë 950,000.00 € . Por ndryshe nga vlerësimi i parë (i këtij komisioni), ky raport nuk ndërmerr asnjë masë për të përjashtuar ofertat e papërgjegjshme , dhe më shqetësuese: lë të hapur derën për një ndryshim të rremë të vlerësimit të mëvonshëm. 04.08.2025 Raporti i katërt – i njëjti komision, por qëndrim i kundërt: SHKELJE ME VETËDIJE APO I NDIKUAR Në raportin e katërt, të hartuar nga po i njëjti komision vlerësues i udhëhequr nga Sami Osmani , ndodh aktualisht shkelja më e rëndë dhe e paarsyetuar : pa ndonjë dokument të ri, pa asnjë fakt shtesë dhe pa ndonjë ndryshim në përmbajtjen e ofertave , të njëjtët operatorë që në dy raporte të fundit paraprake ishin konstatuar si të papërgjegjshëm për qarkullim – papritmas 17 “plotësojnë ” kriterin prej 950,000.00 Euro me referenca nga 569,590.58 të cilat ishin të deklaruara nga vetë komisionet . Si ka mundësi që këta operatorë të shpallur “fitues” arriten papritmas të plotësojnë edhe 380,409.42 Euro !? Me këtë është shkelur KODI PENAL I RKS: NENI 395 Legalizimi i përmbajtjes së rreme dhe Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Po ashtu sipas këtij raporti OE Samire Osmani B.I. nuk është pjesë në vlerësimin e Komisionit Vlersues , ky fakt e përforcon edhe më tepër faktin se ky GOE nuk e përmbushin kërkesat e DT. Kërkesa 1 OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka përfunduar me sukses kontrata në lëminë e D.D.D dhe dezinfektimi n hapësinor në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se 950,000.00 euro . Pas ushtrimit të kërkesës sonë për rishqyrtim të datës 04.07.2025 , e cila është aprovuar si pjesërisht e bazuar , Autori i kontraktues ka realizuar një rivlerësim të ofertave , por edhe në këtë fazë, nuk janë marrë për bazë dokumentet e Samire Osmani B.I., për shkak se subjekti është konsideruar si biznes i shuar . Edhe pas rivlerësimit, shuma totale e kontratave të Operatorëve Ekonomikë të shpërblyer me kontratë ka mbetur e pandryshuar : 569,590.58 €, megjithatë Autoriteti Kontraktues ka vazhduar përsëri duke shpërblyer me kontratë. Edhe sikur të merrej në shqyrtim oferta e Samire Osmani B.I. , siç kemi dëshmuar në analizën financiare dhe teknike profesionale e mëposhtme, ajo nuk do ta plotësonte diferencën prej mbi 130,350.09 € TË REFERENCAVE që mungojnë për të arritur shumën minimale , sepse një pjesë e konsiderueshme e kontratave të saj janë FURNIZIME dhe jo shërbime PËR DDD DHE DEZINSEKTIM HAPËSINORË, SHUMË NGA KONTRATAT të tjera janë të papërfunduara , Disa janë pa referenca dhe Kontrata në emër të biznesit tjetër dhe pa

dokumentacion mbështetës, Dhe vlera reale e dokumentuar dhe e pranueshme për qëllimet e këtij tenderi është vetëm 232,145.53€ Kjo do të thotë se edhe në skenarin më të fav orshëm për operatorët tjerë , vlera kumulative e referencave do të arrinte 819,649.91€ dhe për pasojë kushti minimal prej 950,000.00 € do të mbetet i papërbushur. 18 Po ashtu p ër kërkesën : Kërkesa 2 OE duhet të ketë stafi profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet e D.D.D -së, si dhe përgatitje adekuate shkollore. 3) min. dy (2) Teknik Sanitar me licencë valide të punës, minimumi 2 vite përvojë pune Mungesa e stafit profesional PAS shuarjes së subjektit Samire Osmani B.I. Pas qasjes në dokumentet z yrtare dhe analizës së ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë të shpallur fitues, konstatohet një mangësi serioze në përmbushjen e kriterëve minimale të kapacitetit profesional nga ana e Grupit të Operato rëve Ekonomikë, të përbërë nga: GOE “MBUROYA SH.P.K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë ” Në ofertën fillestare të këtij grupi, ishte paraqitur znj. Fellenza Kollomi si Teknike Sanitare, përmes subjektit Samire Osmani B.I. Megjitha të, në fazën e rivlerësimit, vetë Autoriteti Kontraktues ka vendosur të mos e marrë fare në shqyrtim ofertën e Samire Osmani B.I. , duke e konsideruar atë si biznes i shuar dhe duke mos ia njohur më as kapacitetet njerëzore e as ato financiare. Duke qenë se Teknikja Sanitare Fellenza Kollomi ishte e përfshirë vetëm nëpërmjet këtij subj ekti tashmë të pavlefshëm dhe jo-aktiv , atëherë i gjithë GOE në këtë fazë mbetet vetëm me një (1) Teknik Sanitar , gjë që është në kundërshtim të plotë me kriteret e Dosjes së T enderit, e cila kërkon dy (2) teknikë sanitarë të angazhuar për kryerjen e shërbimeve. Ky fakt nënkupton që grupi tashmë nuk e përmbush as kriterin minimal të kapacitetit profesional, dhe për këtë arsye, oferta e tyre duhej të skualifikohej menjëherë . Mosr eflektimi ndaj kësaj mungese esenciale në raportin përfundimtar të Komisionit Vlerësues përbën një shkelje serioze të Neni t 7 – Barazia në Trajtim / Jo -Diskriminimi t, si dhe tregon për neglizhencë apo qëllimshmëri në favorizimin e operatorëve të caktuar, n donëse ata nuk përmbushin kërkesat minimale të vendosura nga vetë Autoriteti Kontraktues. Për më tepër pas kërkesave për informat a shtes ë, edhe paisjet të ofruara nga Samire Osmani B.I. nuk e plotsojnë kërkesën 1, 3, 5 të ANEKSIT 7 , të Dosjes së Tenderit. Për të cilat do të dokumentohen më poshtë se pse nuk plot ësohen këto kushte. KV dhe ZP kanë bërë shkelje e Rregullorës së Prokurimit Publik Neni 97 pika b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; falsifikim i vlerësimit , mbulim i të pavërtetës me raport zyrtar , dhe shkelje me dashje e parimeve ligjore të prokurimit . Nuk ka vend për gabim teknik, as për lëshim njerëzor. Kjo është një marrëveshje e dakorduar për të legjitimuar paligjshmërinë. 19 Në këtë r aport përfundimtar – i cili është hartuar pas ushtrimit të së drejtës sonë për kërkes ë për rishqyrtim – Komisioni ka tentuar të simulojë një vendimmarrje të ligjshme, ndërkohë që realisht kemi të bëjmë me formalizimin - APROVIM TË e deklaratave të rreme . Përkundër qëndrimit të hapur (KUNDËR) të znj. Arnesa Ferizi , e cila me të drejtë ka kundërshtuar shpalljen fitues të operatorëve që nuk e përmbushin kriterin bazë të qarkullimit minimal 950,000.00€, kryesuesi Sami Osmani dhe anëtari Kasum Morina kanë marrë vendimin përfundimtar me shumicë votash në favor të operatorëve të tjerë – pavarësisht se: NË ASNJËRIN NGA RAPORTET TJERA NUK JANË PËRMBUSHUR OBJEKTIVISHT KRITERET PËR QARKULLIM MINIMAL NGA OPERATORËT FITUES; Ndërsa për ofertën tonë , znj. Arnesa Ferizi ka deklaruar qartë dhe në mënyrë eksplicite se, edhe pse nuk është e drejtë ajo që po bëjmë , në këtë fazë nuk mund të përmirësohen gabimet e bëra nga vetë Autoriteti Kontraktues. Duke shk elur në mënyrë të vetëdijshme KODIN PENAL NENIN 395 Legalizimi i përmbytjes së rreme dhe Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar . Kjo deklaratë është dëshmi e drejtpërdrejtë se komisioni ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për shkeljet ligjore dhe padrejt ësitë që po i bëh eshin ofertës sonë, e cila ishte më e favorshmja ekonomikisht dhe e vetmja që plotësonte kriteret e përcaktuara në dosjen e

tenderit. Në vend që të korrigojnë shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara, ata kanë zgjedhur të mbrojnë dhe të legjitimojnë gabimet e mëparshme të bëra nga vetë AK, duke shkelur me vetëdije të plotë dhe me dashje neni 7 të LPP -së barazinë në trajtim dhe konkurrencën e drejtë. Ky qëndrim jo vetëm që bie ndesh me parimet themelore të ligjit për prokurimin publik, por përbën edhe një veprim të qëllimshëm për të eliminuar ofertën tonë nga gara, pavarësisht se është e përgjegjshme dhe teknikisht e pranueshme. Ky raport përfaqëson ndërhyrje në dhe manipulimi në KV dhe ZP të AK duke injoruar faktet, raportet e mëparshme të qëndrimeve të anëtarëve të komisioneve të mëhershme, si dhe dispozitat ligjore që kërkojnë vlerësim objektiv, të paanshëm dhe të drejtë. Kjo vendimmarrje është e papranueshme në çdo standard profesional, dhe pëbën shkelje të rëndë të parimeve të ligjshmërisë, barazisë dhe konkurrencës së ndershme sipas LPP dhe do të kundërshtohet me të gjitha mjetet administrative dhe ligjore të cilat ne si OE i kemi në dispozicion. 20 AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e tretë (3) të datës : 13.08.2025 Përgjigje për pretendimin e tretë Sa i përket pretendimit se biznesi Samire Osmani B.I është shuar sqarojmë se OE ka dhënë informacione shtesë lidhur me këtë pretendim si më poshtë: OE që më parë ishte i regjistruar si biznes individual Samir e Osmani B.I – 811044247 në emër të Samire Osmani, tashmë ka kaluar në formën juridike Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k), me emrin Eko Lan Group Sh.p.k. me nr. 12244883 -ku pronare e vetme është Samire Osmani. Ky ndryshim është kryer me datën 05.02.2025 dhe nuk përbën ndonjë shuarje përfundimtare të biznesit por vetëm të formës juridike. Si i tillë, ky është vazhdim i biznesit, siç e konfirmon edhe dokumenti zyrtar i lëshuar nga ARBK -ja. Dhe pretendimi juaj është i pabazuar sepse neni 26.1 LPP -së (“Grupi i operatorëve ekonomikë”) ndalon vetëm rastet kur një anëtar i grupit tërhiqet nga gara pas dorëzimit të ofertës. Në këtë rast nuk ka tërheqje, por vetëm ndryshim të formës juridike nga B.I. në Sh.p.k, gjë që nuk ndikon identitetin ekonomik dhe kapacitetin teknik të OE -së. Ky ndryshim nuk është bazë ligjore për skualifikim automatik sipas LPP -së. I. Shkelja e Nenit 26 lidhur me Grupin e Operatorëve Ekonomikë dhe ndryshimi i subjektit gjatë fazës së vlerësimit Përpara se të paraqesim analizën dhe të gjeturat serioze ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë që janë shpërblyer në mënyrë të kundërligjshme nga Autoriteti Kontraktues, theksojmë një shkelje të rëndë procedurale që ka ndodhur qysh në fazën e vlerësimit, lidhur me përbërjen e GOE Mburoya SHPK, Samir e Osmani B.I., N.S.H.ZONA PARK, VLORA AHMETI B.I. EFA DIENSTLEINSTUNG GMBH – Dega në Kosovë” Sipas nenit 26 të Ligjit për Prokurimin Publik, nëse një anëtar i grupit të operatorëve ekonomikë tërhiqet pas dorëzimit të tenderit, atëherë Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të vazhdojë vlerësimin vetëm nëse anëtari i mbetur i përmbush në mënyrë të pavarur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Në të kundërt, duhet të ndërpritet vlerësimi dhe të 21 iniciohet procedura e diskualifikimit në përputhje me nenin 99.2 të LPP -së ndaj anëtarit që ka braktisur grupin. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me një tërheqje nga grupi, por me një veprim po aq të ndaluar: ndryshim të formës juridike të subjektit "Samire Osmani" nga Biznes Individual (B.I.) në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.) gjatë fazës së vlerësimit. Ky transformim i subjektit ekonomik, ndonëse mund të jetë lejuar në kushte të tjera për qëllime afariste, nuk lejohet në kuadër të një procedure të prokurimit publik pas dorëzimit të ofertës – vlerësimit të ofertës, pasi konsiderohet ndryshim thelbësor i identitetit ligjor të ofertuesit, i cili ka dorëzuar dokumentacionin si një subjekt tjetër (psh kontratat me angazhim të stafit KU TANI MË JANË JURIDIKISHT TË PAVLEFSHME). KONTRADITA E RRA DHËS! Në raportin e vlerësimit nr. 4 të datës 04.08.2025 AK nuk i ka marrë parasysh të gjitha të dhënat që janë paraqitur në të OE SAMIRE OSMANI B.I. pasi që ky OE e ka shuar biznesin, siç mund ta shihni të bashkangjitur: Ndërsa për çudi në vendimin B5 8 të publikuar në platformën e prokurimit të datës: 05.08.2025 11:29, AK e vendos si të përgjegjshëm edhe OE Samire Osmani B.I. duke shkelur në mënyrë të drejtëpërdrejtë LPP dhe rregulloren e prokurimit publik. 22 23

AK në refuzimin e kërkesës për rish qyrtim në pretendimin e katërt (4) të datës: 13.08.2025

Përgjigje AK për pretendimin e katërt Për listën e pajisjeve dhe mjeteve teknike të domosdoshme për realizimin e projektit, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që sqarimet nga GOE me datë 27.06.2025 e plotësojnë këtë kriter në tërësi sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Në vijim do të paraqesim për secilin OE mungesat e paisjeve dhe mjeteve teknike që AK i pranon nga GOE si të mirëqena pa verifikim dhe analizë . OE “Samire Osmani B.I Përtej faktit the melor të shuarjes që sipas LPP dhe Rregullorës thotë se gjatë vlersimit të ofertave nuk lejohet ndërrimi i biznesit dhe kjo ofertë konsiderohet e diskualifikuar . Siç ka vepruar edhe vetë KOMISIONI I VLERSIMIT të datës 04.08.2025 këtij OE nuk i është marrë për bazë as edhe një dokument. MIRPO edhe me supozimin “nëse pranohet ” OE si i përgjegjshëm nga AK do t’ju argumentojmë se ky OE nuk i përmbushë kërkesat minimale teknike të të përcaktuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit konkretisht: Pas kërkesës për informacione shtesë nga AK , ky OE ka deklaruar një pajisje ULV elektrostatische multifunkionale . ANEKSI 7 Kërkesa nr. 1: ULV Elektrostatik multifunksional (ELECTROSTATIC ULTRA LOW VOLUME), GJENERATOR ME SHUME FUNKCIONE që punon me biocide të tretshëm në ujë dhe që krijojnë mjegull të ftohtë Sasia e kërkuar 3 copë Operatori Ekonomik SAMIRE OSMANI B. I. i ka ofruar dy pajisje të tilla, duke u mbështetur në faturën nr. 13, të lëshuar më datë 11.11.2017 nga kompania D.P .T “ADIS -B”, pozicioni i 1: Automizer – ULV Gjenerator multifunksional Elektrostatik HD 100 . Megjithatë, ky OE ka dështuar të ofrojë dëshmi të PRONSISË SË SAJ , PAGESËN BANKARE për këtë faturë, DUD - doganorë për importimin e saj, dëshmi mbi specifikacionin teknik , emrin tregtarë , foto, apo të dhëna mbi prodhuesin e kësaj pajisje. Kjo dëshmon se OE ka prezentuar dokumentacion fiktiv. Oe ka tentuar qëllimshëm të bëjë përshkrim të njëjtë me këtë pajisje cilën e ka të deklaruar në DUD -Doganorë NR R-29885 të datës 31.10.2018 makina ka emërtim “DURU HD 100 ULV ” 1- copë , pra nuk është e njëjta pajisje, edhe pse është munduar që përmes kësaj fature fiktive të vë në lajthitje dhe të mashtror AK duke e bërë emërtimin e njëjtë. Ndërsa ky emërtim (Automizer – ULV Gjenerator multifunksional Elektr ostatik HD 100) siç është i shkruar në faturë nuk ekziston fare si pajisje ULV por është SPËRKATËSE MANUALE QË PËRDORET NË BUJQËSI shih linkun zyrtar: <https://www.petratools.com/collections/all-sprayers> 24 Një pajisje e tillë mund të kushtojë deri në maksimum 700 euro në asnjë rrethanë 4500 euro, me këtë kemi dyshim serioz se kjo faturë nuk është autentike. Po ashtu sipas ligjit 08/1 -257 për administrimin e procedurave tatimore citon “Çdo fat urë ndërmjet personave juridikë e cila është me vlerë mbi 300 euro duhet të jetë e paguar përmes transaksionit bankar”, OE ka dështuar që të ofrojë një dëshmi të tillë për këtë faturë. Kjo provon qartë se dokumenti i paraqitur nuk plotëson kriterin ligjor dhe teknik të pranueshmërisë. Pavarësisht kësaj, Komisioni Vlerësues ka vepruar në kundërshtim me detyrimet e tij ligjore duke pranuar këtë dokument si të vlefshëm, duke injoruar mungesën e provës së pagesës bankare. Për më tepër, e njëjta faturë është përdorur në mënyrë të PËRSËRITUR edhe për kërkesën nr. 3 të Aneksit 7 të dosjes së tenderit , gjë që tregon qartazi përdorimin e të njëjtit dokument për më shumë se një herë duke vënë në lajthitje se gjoja i ka dy pajisje të tilla duke rënë ndesh me parimet e konkurrencës së drejtë dhe transparencës në prokurimin publik. 25 Gjithashtu, bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 01/2019 -UA për caktimin e kërkesave, kushteve dhe procedurave për krijimin e numrit unik identifikues , dyshojmë fatura TATIMORE ME NUMËR RENDOR 13 të datës 11.11.2017 është fiktive . Sepse ky udhëzim ka hyrë në fuqi pas vitit 2019, dhe përpara kësaj periudhe bizneset në ARBK regjistroheshin vetëm me emrin tregtar të biznesit , pa u shoqëruar me prapë shtesën “B.I.” me emër të pronarit. Në rastin konkret, fatura është lëshuar në vitin 2017 po ashtu edhe fatura nr. 10 të datës 06.07.2018 dhe nr. 11-të datës 07.07.2018 për subjektin “ SAMIRE OSMANI B.I. – LESHAN, SUHAREKË ”. Në atë kohë, sipas rregullimit ligjor në fuqi, nuk ka qenë e mundur që

një biznes i regjistruar të mbante këtë emërtim me shtesën “B.I.” , pasi kjo formë identifikimi është bërë e aplikueshme vetëm pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ të vitit 2019. 26 Prandaj, fakti që faturat e vitit 2017 dhe 2018 mban emërtimin “SAMIRE OSMANI B.I.” dëshmon qartë se ajo nuk mund të jetë fat urë autentike dhe për pasojë paraqet elemente fiktive dhe falsifikimit të dokumentit financiar. Kjo mospërputhje kohore ndërmjet datës së faturës dhe emërtimit ligjor të biznesit sipas regjistrimit në ARBK mund të jetë provë e mjaftueshme dhe bindëse për t’ë konstatuar dyshimin e bazuar se dokumenti -Fatura nuk pasqyron një transaksion të ligjshëm. Kjo përbën përdorim/prezentim të dokumenteve të dyshuara të falsifikuara dhe cenon drejtpërdrejt ligjshmërinë e ofertës së operatorit ekonomik në fjalë. Në shkelje të dispozitave ligjore: Rregullorja e Prokurimit Publik Neni 97 pika b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; Kodi Penal i Republikës së Kosovës Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik. Kërkesa në Aneksin 7 pika 5 : 5 Pompa motorike LV (LOW VOLUME). 20 Samire Osmani B.I ka ofruar 20 (njëzet) pajisje për pikën 5. Dëshmitë e ofruara për këtë pikë janë: Fatura nr. 13 , e lëshuar më datë 11.11.2017 nga kompania D.P.T “ADIS -B” – 1 copë. Në përshkrim shënohet “Automizer ULV Gjenerator Multifunksional Elektrostatik HD 100 ”, e cila dyshohet se është faturë Fiktive . Fatura nr. 13 , e lëshuar më datë 11.11.2017 nga kompania D.P.T “ADIS -B” – 4 copë . Në përshkrim shënohet “pomper dore Low Volume ”, e cila nuk është motorike. Fatura nr. 11 , e lëshuar më datë 07.07.2018 nga kompania D.P.T “ADIS -B” – 3 copë . Në përshkrim shënohet “pomper dore Low Volume ”, e cila nuk është motorike. Fatura nr. 10 , e lëshuar më datë 06.07.2018 nga kompania D.P.T “ADIS -B” – 3 copë . Në përshkrim shënohet “pomper dore Low Volume ”, e cila nuk është motorike. Pajisjet e ofruara “Pomper dore Low Volume ” (pomper nuk është as emërtim i saktë as pompë motorike) nuk përmbushin kërkesën nr. 5 të Aneksit 7 të DT pasi që për asnjërën nuk ka specifikacion teknik që e dëshmojnë pompën që është sipas kërkesës për “Pompa motorike LV (LOW VOLUME). ” 27 Fatura TATIMORE me nr. të faturës 20-SHV04 -01-69 e datës 31.05.2020 e lëshuar nga biznesi “Arsim A. Gashi ” B.I. në përshkrim në pikën 2 të faturës. Gjenerator ULV elektrostatik multifunksional (ELEKTROSTATIC ULTRA LOW VOLUME), Pajisje që punon me biocid dhe krijon mjegull të ftohtë – 1 copë . Kjo Faturë/pajisje është e dyshimtë sepse nuk ka EMERTIM të pajisjes, specifikacion teknik dhe në Emëtim Shkruan SHËRBIME kurse në fakt tregon për shitje dhe si e tillë nuk mund të verifikohet kohë pajisja. 28 Në përmbledhje, OE “Samire Osmani B .I.” duhet të skualifikohet për mospërmbushje të kërkesave minimale teknike për pajisjet , përfshirë mungesën e të dhënave identifikuese, specifikacioneve teknike, dhe dokumenteve të pronësisë , emërtimeve të dyshimta, pagesave bankare . Në listën e kontratave të paraqitura me stafin teknik nga OE Samire Osmani B.I. , konstatohet një mospërputhje logjike dhe faktike. Sipas certifikatës së biznesit, ndërrimi i emrit në formën “B.I.” 29 është bërë më datë 08.05.2020 . Megjithatë, në dokumentacionin e ofertës figurojnë kontrata të përpiluara në vitin 2016 dhe 2018 në emër të OE Samire Osmani B.I. , me shënimin e Numrit Unik Identifikues 811044247 . Ky fakt është i pasaktë dhe i pavlefshëm për këto arsye: 1. Në vitet 2016 dhe 2018 nuk ka ekzistuar Numri Unik Identifikues (NUI) për kompanitë e regjistruara në ARBK. Në atë periudhë, kompanitë identifikoheshin vetëm me numrin e biznesit (NRB) dhe jo me NUI, pasi ky i fundit është futur në përdorim vetëm pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2019 . 2. Emërtimi me shtesën “B.I.” nuk ka qenë i aplikueshëm para vitit 2020 , pasi ky ndryshim është bërë zyrtarë më 08.05.2020 . 3. Si rrjedhojë, kontratat me stafin e OE të paraqitura me këtë emërtim dhe me shënim të NUI-t për vitet 2016 dhe 2018 janë jo valide dhe të pavlefshme , sepse përmbajnë elemente që nuk kanë ekzistuar ligjërisht në atë periudhë kohore. Kjo përbën përdorim të dokumenteve të falsifikuara dhe cenon drejtpërdrejt ligjshmërinë e ofertës së operatorit ekonomik në fjalë. Në shkelje të dispozitave ligjore : Rregullorja e Prokurimit Publik Neni 97

pika b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; Kodi Penal i Republikës së Kosovës Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik. OE “Vlora A. Ahmeti B.I. (BIOGREEN DDD)” Deklarime të rreme, mungesë pajisjesh dhe dokumentacioni Operatori Ekonomik “Vlora A. Ahmeti B.I.” është shpërblyer me kontratë përkundër një sërë shkeljesh serioze dhe të pakontestueshme të kriterëve minimale teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofruar nga ky OE rezulton qartë se kemi të bëjmë me mashtrim për paisje t, e cila jo vetëm që e skualifikon ofertën e tyre në mënyrë të menjëhershme, por ngre dyshime të forta për vënien në lajthitje të Autoritetit Kontraktues përmes deklaratave të rreme nën betim, gjë që përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullorja e Prokurimit Publik Neni 97 pika b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; Kodi Penal i Republikës së Kosovës Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik.

I. Deklaratë e rreme për pajisjet ULV elektrostاتيke multifunksionale Në Aneksin 7, OE “BIOGREEN DDD” deklaron se ofron dy (2) pajisje ULV elektrostاتيke multifunksionale, të domosdoshme për trajtimin efikas të zonave të ekspozuara për EHKK. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vetë marrëveshja noteriale që ata e kanë bashkëngjitur, konstatohet se: 30 Marrëveshja noteriale e datës 19.11.2024 me N.SH “EKO-DDD” Ferizaj përfshin vetëm një (1) pajisje ULV të llojit MMT Hunter Mist Blower 35HP dhe një automjet me targa RKS 05 -979-FS, pra në kundërshtim të plotë me deklarin e bërë në Aneksin 7, ku pretendohet se janë dy (2) pajisje të tilla. 31 32 Gjithashtu kjo paisje nuk është ELEKTROSTATIKE MULTIFUNKSIONALE sipas specifikacioneve teknike të prodhuesit. Referojuni linkut zyrtar: <https://gunesilacnama.com/en/urun/mmt-hunter-spd-35-400-2/> Kjo përbën deklarin të rremë nën betim, në kundërshtim me Nenin 65 të LPP -së, si dhe përpjekje të qëllimshme për manipulim të të dhënave, për të paraqitur pajisje që realisht nuk ekzistojnë në dispozicionin e operatorit. Paisja e deklaruar nuk përmban asnjë specifikim teknik siç kërkohet në dosjen e tenderit. Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit (Aneksi 7 pika 1), operatori duhet të dëshmojë pajisjet me: Libreza të regjistrimit të valide, Fatura blerjeje, DUD doganorë. OE Vlora A. Ahmeti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi formale për pajisjet e deklaruarat. Të gjitha deklaratat mbështeten vetëm në Formate boshe të listave, Deklarime të vetë OE -së pa specifikacion teknik të paisjeve. Për kërkesën 2 të Aneksit 7: Fumigatorë dhe gjeneratorë dore LV – OE ka deklaruar vetëm një (1), dhe ajo pa asnjë dëshmi pronësie. Në veçanti, për kërkesën 4 të Aneksit 7: Gjeneratorët ULV – ka deklaruar se ofron 4 copë, por nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi për pronësi apo qira të paisjeve, përveç një përshtkrimi në pjesën e të dhënave të paisjes OE deklaron Pompa Motorrike Low Volume. (në kundërshtim me kërkesën) duke tentuar ta vë në lajthitje me qëllim AK. Për kërkesën 5 të Aneksit 7: Pompat motorrike LV – ka deklaruar 4 copë, dhe për asnjë nuk është bashkëngjitur faturë, DUD apo specifikacion teknik. Ndërsa në pjesën e të dhënave të paisjes OE DEKLARON “Paisje profesionale për Dezinsektim dhe Dezinfektim”. 33 Duke qenë nën deklaratën nën Betim OE bënë d eklarim të rremë për posedim të pajisjeve dhe pa dokumentacion mbështetës, përbën: Mashtim ndaj Autoritetit Kontraktues, Shkelje e deklaratës nën betim. Mungesa e pajisjeve teknike nënkupton se ky OE nuk është në gjendje të realizojë kontratën, qoftë në aspekt teknik, qoftë në aspekt profesional. Në rast të zbatimit të kontratës, ekziston rreziku i madh që shërbimi të mos përmbushet fare ose të përmbushet në mënyrë të rrezikshme për mjedisin dhe popullatën. OE “Vlora A. Ahmeti B.I. – BIOGREEN DDD” duhet të refuzohet si OE i papërgjegjshëm dhe të futet në listën e zezë të OSHP në përputhje me: Nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, Aneksin 7 të DT -së, për mungesë dëshmish të pajisjeve, dhe Nenin 65, për deklarata të rreme nën betim. Vazhdimi i pranisë së këtij OE në garë, për më tepër shpërblyeri me kontratë në kuadër të GOE, përbën: Ceni më të rëndë të së drejtës për pjesëmarrje të barabartë në procedurën e prokurimit; Dëmtim të integritetit

dhe besueshmërisë së procesit të vlerësimit. 34 OE “Mburoya Sh.P.K. ” Mungesë planit dinamik të detajuar , staf i pakualifikuar, dokumentacion i dyshimtë dh e përdorim i diplomës të pa nostrifikuar. Operatori Ekonomik “Mburoya Sh.P .K. ”, i shpërblyer me kontratë në këtë aktivitet prokurimi, përfaqëson një nga rastet më të theksuara të papërgjegjshmërisë, mungesës së aftësisë totale profesionale dhe teknike dhe manipulimit dokumentar. Një ofertë e tillë, nëse do të ishte trajtuar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe kriteret e Dosjes së Tenderit, nuk do të duhej të kishte kaluar as fazën fillestare të vlerësimit. I. Mungesa totale e Planit të Implementimit – dështim në Aneksin 1 të DT -së Aneksi 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME pika B OPERATORI EKONOMIK DUHET TE OFROJ PËRSHKRIMIN E MËNYRËS SË IMPLEMENTIMIT TË KËTIJ SHËRBIMI/PROJEKTI. o Trajtimi i detajuara i sipërfaqeve sipas vendeve, fshatra ve apo qytetit; o Teknikat/mënyra e ndërhyrjes (përshkrimi i shërbimit); o Staf i profesional dhe numëri i stafit të angazhuar; o Stabilimentet dhe pajisjet e përdorura për kryerjen e shërbimit; o Specifikat me të dhënat teknike për Makineritë, Pajisjet dhe Mjete t e përdorura për kryerjen e shërbimit; o Përmbajtjen Lëndës aktive dhe shkalla e përqendrimit të tretësirës që do të përdoret për trajtim; o Numri i trajtimeve për 1 vit; o Ora e kryerjes se shërbimit, data; o Të dhënat për faktorët klimatik: Temperaturat, Erë rat dhe Niveli i ujit nëntokësor dhe distanca nga ujërat sipërfaqësorë (lumenj, liqeje, rezervuare). o C. PREPARATET -PRODUKTET QË DUHET TË PËRDOREN PËR DEZINSEKTIMIN HAPSINOR SELEKTIV TE ZONAVE ENDEMIKE TE EKSPOZUARA PER ETHET HEMORRAGJIKE KRIME -KONGO OE M buroya nuk ka paraqitur asnjë plan të implementimit të punës sipas Aneksit 1 pika B ,C por vetëm një përshkrim të thatë, që nuk përmban asnjë nga elementët thelbësorë të kërkuar . Kjo përbën jo vetëm shkelje të Aneksit 1, PIKA B DHE C , por një mungesë TOTALE të një plani profesional dhe teknk e në zbatimin e një kontrate të ndjeshme publike të kërkuar në DT. Në mungesë të këtij plani, OE nuk janë në gjendje të realizojnë projektin dhe përmbushur kërkesat e DT, dhe për më tepër, nuk ka asnjë strategji të parashikuar për mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore, siç janë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore – çështje kyçe në një projekt që ka për synim dezinfektimin në zonat me rrezik për EHKK . 35 AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e pestë (5) të datë s: 13.08.2025: Përgjigje AK për pretendimin e pestë Sa i përketë mungesës së planit për realizimin e projektit, GOE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar ofertën, planin dhe meto dologjinë e detajuar për realizimin e projektit. Gjithashtu, ka ofruar edhe ditarin e shërbimeve me të gjitha detajet. Si rrjedhojë, GOE e ka plotësuar në tërësi kërkesën e AK dhe pretendimi është i pa bazuar. Në kërkesën tonë për qasje në dokumentet zyrt are AK si në ofertën fillestare po ashtu edhe kërkesës për ri -qasje në dokumentacion , AK e dërgon të gjithë dokumentacionin përfshirë edhe e-mailët zyrtare ndërmjet ZP , KV dhe njësisë kërkuese poashtu edhe sqarimet e kërkuara nga AK për GOE “MBUROYA SH.P .K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë ” të dërguara në e -mail zyrtar të OE Doctor Exterminator DDD SHPK me datë 06.08.2025 . Në asnjë nga dokumentet e ofruara si në dokumentat e ofertës 2024 poashtu edhe pas kërkesës për informacione shtes ë të vitit 2025 nga AK, GOE nuk kanë prezentuar “Plani i realizimit të projektit sipas kërkesës ” nr. 5 Aneksit 1, PIKA B DHE C siç është pretenduar nga AK. Kërkesa 5 Përshkrimin e mënyrës së implementimit të këtij shërbimi. Dëshmi 5 OE duhet të ofroj met odologjin përshkrimin se si do të implementoj projektin. AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në pretendimin e gjashtë (6) të datës: 13.08.2025 : Përgjigje për pretendimin e gjashtë (6) Lidhur me diplomën dhe licencën e epidemiologes znj. Lebibe Hashan i, sqarojmë se këto dokumente janë të noterizuara ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu sa i përketë përvojës së punës, kjo situatë është sqaruar me datën 28.04.2025. Andaj pretendimi juaj është i pabazuar. AK pa e shtjelluar fare pretend imin tonë jep përgjigje të shkurtë dhe

skandaloze se gjoja Diploma e Noterizuar është e barazvlefshme me Nostrifikim apo njohje sipas sipas ligjit të arsimit të lartë . Ku çdo diplomë e lëshuar jashtë institucioneve vendore të arsimit të lartë duhet të nënshtruhet njohjes / nostrifikimit në bazë udhëzimit administrative (MASHT) nr.12/2018 nenit 2 pika 1.1,1.2,1.3,1.5 dhe 1.7 parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës . Duke e bërë atë automatikisht të pavlefshme – JO VALIDE për përdorim në procedura të punësimit ose angazhimit profesional në çfardo pune apo angazhimi profesional projekte të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës apo veprimtari private ku kryhen shërbime 36 publike . Ky fakt i vetëm, është i mjaftueshëm për ta skualifikuar ofertuesin, por edhe ndjekur penalisht për ushtrim të profesionit në menyrë të paligjshme dhe përbën shkelje të drejtpërdrejtë të kriterëve të kualifikimit dhe një cenim të integritetit të procesit të prokurimit Epidemiolog – Dr. Lebib Hashani Ky OE ka paraqitur znj. Lebib Hashani si “epidemiolog ” për këtë projekt. Megjithatë, analiza e dokumenteve të saj tregon shkelje të qarta të kriterëve ligjore dhe teknike të Dosjes së Tenderit. Përmes këtij veprimi është anashkaluar detyrimi ligjor sipas udhëzimit administrativ (MASHT) nr.12/2018 për njohje/ nostrifikimin e diplomave të lëshuara nga jashtë sistemit të arsimit të Republikës së Kosovës, veçanërisht atyre të dala nga periudha e regjimit okupues të Serbisë 1998 -1999. Për më tepër, kjo diplomë është e lëshuar në gjuhën serbe (cirilike) më datë 08.06.1998 , në kulmin e regjimit shtypës dhe pushtues të Slllobodan Millosheviqit – periudhë kur institucionet e Kosovës ishin nën administrimin e dhunshëm të Serbisë dhe Shqipëtarëve u mohohet qasja në arsim e shëndetësi. Pranimi i një dokumenti zyrtar të lëshuar nga një Regjim sundues që ka kryer krime sistematike ndaj popullit të Kosovës, përveçse është fyerje dhe diskriminim ndaj profesionistëve vendas, përbën: Injorim të pavarësisë institucionale të Republikës së Kosovës; Degradim të institucioneve shtetërore, të cilat duhet të shpërndajnë fonde vetëm përmes prokurimeve të ndershme dhe meritore . Rrezik të drejtë përdrejtë për sigurinë kombëtare. Pas analizimit të CV-ve të stafit profesional të paraqitur tregojnë mungesë të plotë të përvojës relevante mbi EHKK, rriqrat apo vektorët e tjerë biologjikë. Trajnimet e ndjekura prej saj lidhen të cilat janë të shkruara në CV me tema periferike e jo -relevante për projektin (HIV/AIDS, duhani, ushqimi në Prevallë, etj.). Bashkangjitur keni CV-të DT 2024 dhe pas Kërkesës për informacione shtesë 2025 . 37 Gjithashtu, ekziston një kontradiktë e hapur midis CV -së dhe dokumenteve të tjera të paraqitura: në CV thuhet se znj. Hashani është pjesë e stafit të OE -së që nga viti 2024 me kontratë të pacaktuar, ndërsa në parakontratën e dorëzuar thuhet se do të angazhohet vetëm për këtë projekt. 38 39 Epidemiologu dhe Ekologu – mungesë totale e njohurive të specializuara dhe dokumentacioni i rremë sipas CV-ve të dorëzuara Kërkesa 2 Min. 1) një (1) Epidemiolog ose Ekspertë në shëndet publik që ka njohuri për sëmundjet që mund të transmetohen nga rriqrat dhe strategjitë për të zvogëluar rrezikun e tyre. Minimum 2 vitet e përvojë pune 2) Min. një (1) Ekologë që ka njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre. Minimum 2 vite përvojë pune. Dëshmi 2 OE për stafin profesional duhet të dëshmojë me diplomë të noterizuar, CV, licenca si dhe kontratë apo para kontratë që dëshmon se stafi do të angazhohet gjatë realizimit të projektit. CV-të e dorëzuar në ofertën fillestare nuk ka plotësuar kërkesat e DT. AK ka kërkuar sqarime shtesë edhe pse në kundërshtim me nenin 69 të LPP, mirëpo edhe pas sqarimit të datës 28.04.2025 nga OE Mburoja SHPK , mbeten të njëjta CV pa ndryshime dhe si të tilla nuk i plotësojnë kërkesat e DT dhe sipas Neni 69 duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informata shtesë AK ka vepruar në kundërshtim me LPP Neni 69 ku udhëzuesi nr. 001/2023 në faqe 40 t'hotë: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 69 Si Epidemiolog është propozuar Dr. Lebib Hashani me diplomë të pa nostrifikuar , Licencë të punës dhe si ekolog është propozuar z. Pajtim Bytyqi, me diplomë Bachelor nga UP në Biologji – Ekologji

dhe Mbrojtje të Ambientit. Megjithatë, nga CV-të dhe dokumentacioni: Nuk rezulton të ketë ndonjë trajnim, certifikatë, apo publikim profesional mbi rriqrat, identifikimin e tyre apo metodat biologjike të kontrollit – që është kërkesë eksplicite në Aneksin 1. Ka paraqitur parakontratë të përgjithshme, por jo dëshmi për eksperiencë reale në fushën që ka rëndësi kritike për këtë projekt. Prandaj, edhe ky “staf profesional” nuk përmbush as kriteret minimale të përcaktuara në DT, që ka njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre dhe mbështetja - Ekspertiza në të për një projekt me risk biologjik përbën rrezik direkt për shëndetin publik dhe mbarëvajtjen e projektit. Stafi i OE Mburoya Sh.P .K. nuk është kompetent, as në aspektin teknik, as në atë profesional e ligjor. Për më tepër, përfshirja e një diplome nga regjimi okupator, pa nostrifikim, nuk është në përputhje të kërkesave të projektit. 40 PIKA IV — OE “NSHH Zona Park” Shkelje të Aneksit 7 – mungesë e dëshmive për pajisjet, mashtrim teknik dhe deklarime të rreme që komprometojnë sigurinë e projektit N.SH.H “Zona Park” ka ofruar, për këtë pikë, një (1) pajisje të blerë më datë 19.08.2020 nga IGEBA Geraetebau GmbH – Gjermani, me numër fature ABE-4890 -20 dhe dokument doganor të datës 24.08.2020, me numër referues 2020 #338, nga pika doganore Vermicë – Prizren. Në përshkrimin e emërimit të pajisjes në faturë (numër rendor 3), Paisja është ULV elektrike dhe JO Gjenerator multifunksional elektrostatik – ULV elektrostatik Multifunksional siç është kërkuar në kërkesën nr. 3 të Aneksit 7; Paisja e ofruar është me kapacitet të rezervuarit të solucionit 6 Litra që e bënë të pa përdorshme në hapësirat e jashtme për projektin e prezantuar Dezinsektim hapësinor. Shih Linkun zyrtar të specifikacionit të pajisjes: https://igeba.de/en/product/unipro_-2/ Në kërkesën nr. 5 të Aneksit 7 janë kërkuar: 5 Pompa motorike LV (LOW VOLUME). 20 N.SH.H “Zona Park” ka ofruar për këtë pikë mbi 20 (njëzet) pajisje të blera nga Durimi Trade SHPK me numër fature 306 të datës 07.06.2020, ku shënohen: Spërkatëse me rrymë Pompë spërkatëse 8.0L Pompë spërkatëse shpine 12L Farm Pompë spërkatëse shpinë 5L 41 Spërkatëse ERGO TT Spërkatëse manual dhe bateri Volter Asnjëra nga këto pompa nuk ka specifikacion teknik që të dëshmojë përputhshmërinë me kërkesat e pikës 5 të dosjes së tenderit. Gjithashtu janë ofruar edhe: Fatura nr. 194, datë 16.03.2020 Spërkatëse SR 450 STIHL, 1 copë (pa specifikacion) Fatura nr. 4092251, datë 10.06.2019 Pompë spërkatëse me benzinë 20L 450 -2, 1 copë (pa specifikacion) Pompë spërkatëse shpine 16L Farm (pa specifikacion) Fatura nr. 527, datë 19.05.2018 Spërkatëse SG 31 EU, 3 copë (pa specifikacion) Fatura nr. 482, datë 30.04.2018 Spërkatëse SG 51 EU, 5 copë (pa specifikacion) Pompë spërkatëse 20L 435, 3 copë (pa specifikacion) Pompë spërkatëse 15L, 3 copë (pa specifikacion) Për të gjitha këto fatura mungojnë dëshmitë e pagesave. 42 43 I. Pajisjet ULV –Mospërputhje mungesë specifikacionesh, origjine dhe identiteti teknik (nuk janë në përputhshmëri me Kërkesat e aneksit 7) II. OE NSHH Zona Park me dashje dhe vetëdije të plotë ka mashtruar AK për pajisjet e kërkuara sipas DT Aneksi 7 duke deklaruar të dhëna të rreme lidhur me funksionin dhe numrin e pajisjeve ULV Elektrostatike Multifunkionale, siq mund të vëtetohet lehtësisht në DUD doganore, Faturë, foto, Specifikime teknike të pajisjeve të prezentuara. Në përputhje me Aneksin 7 pika 1 të DT, OE -të obligohen të paraqesin: ? specifikacione teknike të pajisjeve të ofruara, dëshmi për pronësi të pajisjeve (faturë, DUD), ose marrëveshje qiraje të noterizuar dhe të lidhur posaçërisht me këtë projekt. Pra nga ky verifikim konstatojmë se i gjithë GOE për kërkesën nr. 5 të aneksit 7 për: Pompa motorike LV (LOW VOLUME), Sasia e kërkuar nga AK 20 copë ndërsa i gjithë GOE ka ofruar me dokumentacion valid vetëm 14 copë dhe GOE nuk përmbush kërkesën minimale prej 20 copë dhe si i tillë është i papërgjegjshëm dhe duhet të futet në listë të zezë për deklarime të rreme. Në kërkesën e AK Kërkesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 44 Në Kërkesa 4. Lista e pajisjeve, mjeteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifi kimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 7 Dëshmi 4 Të dhënat për

pajisjet. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmojnë me librezën e regjistrimit valide, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (fa turë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar. OE ka deklaruar automjete jo valide dhe pa kontrata qiraje valide. Vetura me targa 04 -982-HG data e skadimit ??10.2024 (?? Nuk shihet data) I skaduar në kohën e aplikimit) Pra automjeti i prezantuar në ofertën e Zona Park është JO VALIDE. Po ashtu në kontratën e qirasë të datës 15.04.2024 ndërmjet Mburoya SHPK dhe Arbnor Hoti për automjetin me targa 04 -409-HI, në kontratën e datës 15.04.2024 ndërmjet Mburoya SHPK dhe Ali Kastrati për auto mjetin me targa 04 -463-KG dhe në kontratën e qirasë ndërmjet Mburoya SHPK dhe Leme Hoti Selaj për automjetin me targa 04 -202-JO në kërkesën e AK në kërkesën 4 Dëshmia dokumentare citojmë: Pra marrëveshja është e noterizuar me datë 16.04.2024 për nevoja të kompanisë dhe JO sipas kërkesës së AK në DT në emër të Projektit! 45 Të gjeturat pas analizimit të detajuar të dokumentacionit bazë dhe atij pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK për GOE janë si më poshtë: 1. Mos përmbushjes e kërkesës nr. 1: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka përfunduar me sukses kontrata në lëmin e D.D.D dhe dezinfektimit hapsinor në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo me pak se 950,000.00 euro Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmi 1 Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 8, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten certifikatat e pranimit apo referencat. GOE i rekomanduar për kontratë ka gjithsej: Vlera TOTALE e referencave sipas llogaritjeve: 819,649.91 € Vlera totale pa OE SAMIRE OSMANI B.I. SI BIZNES I SHUAR 587,504.38 € Pas kërkesës për informacione shtesë nga AK për GOE GOE “MBUROYA SH.P.K Samire Osmani B.I. & N.SH.SH. “ZONA PARK & Vlora A. Ahmeti B.I & Efa Di enstleistung GmbH – Dega në Kosovë ” vendosë listen e kontratave siç janë më poshtë: 46 OE “MBUROYA ” SHPK Kontratë nga OE EKOLOGJIA SHPK Kontratë e pa përfunduar 47 48 KONKLuzion : Nga analiza e mësipërme rezultoi qartë se OE “MBUROYA ” SHPK ka bërë deklaram të rrejshëm gjoja për realizimin e kontratave me referenca për shërbimet e DDD dhe Dezinfektimit hapsinorë sipas DT, duke përfshirë në listë kontrata të papërfunduara, kontrata që nuk përputhen me përkufizimin e “shërbimeve të ngjashme”, kontrata dhe Referenca të dyfishta dhe kontrata pa referenca të vlefshme, kontrata në emër të kompanive tjera . Duke vërë në lajthitje me dashje AK duke tentuar ta manipuloj dhe huttoj se gjoja i përmbush kërkesat mbi KAPACITETIN TEKNIK DHE FINANCIAR 9.1&9.2 DT Ky veprim bie ndesh me Nenin 99.1(b) të Rregullores për Prokurimin Publik dhe duhet të çojë në skualifikim të menjëhershëm dhe ndalim për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik për një periudhë jo më pak se 12 muaj sipas nenit 99.3 të Rregullores . Dhe procedim penal për mashtrim në tender me qëllim përfitimi nga fondet publike të R.Kosovës 49 OE ZONA PARK në listen e ofruar janë si më poshtë 50 51 52 53 OE Vlora A. Ahmeti B.i në listen e ofruar janë si më poshtë: 54 55 OE SAMIRE OSMANI B.I. në listen e ofruar janë si më poshtë 56 57 58 59 RIKAPITULLIM : Në pika të shkurta po i paraqesim mungesat e dokumentacionit të secilës kërkesë në DT. 1. Kërkesa: Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare Kërkesa 1 OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka përfunduar me sukses kontrata në lëmin e D.D.D dhe dezinfektimit hapsinor në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo me pak se 950,000.00 euro Dëshmi 1 Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 8, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten certifikatat e pranimit apo

referencat. OE ZONA PARK: 155,115.99 € OE MBUROJA: 230,506.35 € OE SAMIRE OSMANI B.I.: 232,145.53 € OE VLORA AHMETI B.I.: 201,882.04 € OE EFA DIENSTLEINSTUNG GMBH: 0.00€ Vlera TOTALE e referencave sipas llogaritjeve: 819,649.91 € Vlera totale pa OE SAMIRE OSMANI B.I. 587,504.38 € dhe pas dokumenteve shtojca. 2. Kërkesa: Kërkesa 2 OE duhet të ketë stafi profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet e D.D.D -së, si dhe përgatitje adekuate shkollore. 1) Min. një (1) Epidemiolog ose Ekspertë në shëndet publik që ka njohuri për sëmundjet që mund të transmetohen nga rriqrat dhe strategjitë për të zvogëluar Dëshmi 2 OE duhet të dorëzojë një listë të stafit duke saktësuar pozitën – rolin në këtë projekt. OE për stafi n profesional duhet të dëshmojë me diplomë të noterizuar, CV, licenca si dhe kontratë apo para kontratë që dëshmon se stafi do të angazhohet gjatë realizimit të projektit. Për stafin shtesë të dëshmohen diploma apo certifikatë të trajnimeve, si dhe Kontra ta apo para 60 rrezikun e tyre. Minimum 2 vite përvojë pune 2) Min. një (1) Ekologë që ka njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre. Minimum 2 vite përvojë pune. 3) min. dy (2) Teknik Sanitar me licencë valide të punës, minimumi 2 vite përvojë pune. kontrata që dëshmon se stafi do të angazhohet gjatë realizimit të projektit. Epidemiologu pa njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre. , pa diplomë të nostrifikuar – njohur. Ekologu pa njohuri njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre. Tekniku Sanitar (2) – i pranuar vetëm një (1). 3. Kërkesa: Kërkesa 4. Lista e pajisjeve, mjeteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 7 Dëshmi 4 Të dhënat për pajisjet. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit valide, ndërsa p ajsje tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje ! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar. Kërkesa aneksi 7 pika 1. ULV Elektrostatik multifunksional (ELECTROSTATIC ULTRA LOW VOLUME), GJENERATOR M E SHUME FUNKCIONE që punon me biocide të tretshëm në ujë dhe që krijojnë mjegull të ftohtë kërkuar 3 copë . 61 GOE sipas të gjeturave që u cekën më lartë asnjëra paisje e deklaruar nuk e plotëson këtë kërkesë. Pra 0 copë Pika 3. Se paku një Gjenerator multifunksional elektrostatik - ULV elektrostatik Multifunksional; kërkuar 1 copë GOE nuk e plotëson këtë kërkesë 0 copë . Pika 5. Pompa motorike LV (LOW VOLUME). Kërkuar 20 copë GOE pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranueshme janë vetëm 14 copë . Nëse Komisioni i Vlerësimit do të kishte ushtruar detyrën e tij në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe me minimumin e profesionalizmit institucional , asnjë nga operatorët e shpërblyer nuk do të kishte kaluar as filtrin elementar të vlerësimit . Në vend të kësaj, komisioni ka: ? Injoruar mungesën e dokumentacionit bazë dhe teknik , përfshirë mungesën e dëshmive për pajisje , kapaciteteve financiare dhe stafit profesional ; ? Ka miratuar deklaratimet e rreme nën betim , që në çdo shtet me integritet institucio nal do të trajtoheshin si vepra penale; Për këtë situatë të krijuar, përgjegjësia bie para së gjithash mbi: ? Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit , të cilët me shkelje ligjore të dokumentuara kanë legjitimuar operatorë me mungesa të theksuara ligjore, teknike dhe etike; ? Zyrtarët e Zyrës së Prokurimit , të cilët kanë hartuar, përkrahur dhe miratuar këtë proces të shtrembëruar, në kundërshtim me faktet reale , ligjin në fuqi dhe çdo parim të përgjegjësisë publike. ? Njësia kërkuese z. Isuf Cikaqi ka inicuar projekti n “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe Hemorragjike Krime Kongo ” me reference 04 -425/24 të datës: 03.09.2024 me nr. të protokolit: 3293 nr. i faqeve 10, përmes Venera Çerkinit drejtuar zyrës së Prokurimit së MBPZHR. Zyra e Prokurimit ka ndryshuar kriteret në Dosjen e Tenderit pa njoftuar dhe pa

marrë pëlqimin e njësisë kërkuese (z. Isuf Cikaqi). Ky veprim, që bie ndesh me kriteret e inicuar nga vetë njësia kërkuese, përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik dhe njëkohësisht është i dënueshëm sipas dispozitave të Kodit Penal. 62 Ky nuk është vetëm një rast i eliminimit të një OE -je të përgjegjshëm. Ky është një skandal i rëndë institucional që rrënon themelet e prokurimit publik në Kosovë dhe krijon precedent për favorizim, klientelizëm, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe shpërdorim të fondeve të shtetit. KËRKESAT TONA Në bazë të të gjitha shkeljeve të konstatuara dhe të argumentuara në këtë ankesë, kërkojmë nga AK - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të marrë ven dim meritore në këto pika: Anulimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë si të papërgjegjshme, pasi arsyetimi i përdorur bazohet në një kriter fiktiv (“licenca për ekolog”), i cili nuk ekziston në asnjë akt ligjor ose nënligjor në Republikën e Kosovës, siç është vërtetuar me dokumente zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit. Rrëzimin e pranimit të licencës për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) nga ofertuesit e shpallur fitues si të barasvlefshme me “licencën e ekologut”, pasi kjo licencë ka natyrë krejt tjetër, është e rregulluar vetëm për hartimin e raporteve të VNM -së sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 10/2017 dhe nuk dëshmon kualifikim profesional individual për profesionin e ekologut. Konstatimin e konfliktit të hapur të interesit në rastin e kompanisë “Mburoya”, ku personi Pajtim Bytyqi, i licencuar për hartimin e raporteve të VNM -së, është i punësuar në këtë kompani, duke bërë të jashtëligjshme hartimin e raporteve për të njëjtën kompani ku ai është i punësuar, në kundërshtim me parimet e integritetit profesional dhe paanshmërisë. Rivlerësimin e plotë nga një komision i ri vlerësues, duke përjashtuar anëtarët aktual të komisionit për shkak të aplikimit të standardeve të dyfishta, legalizimit të dokumenteve të rreme, keqinterpretimit të ligjit, pranimit të dokumenteve të papërpunueshme dhe diskriminimit të hapur ndaj ofertës sonë. Zbatimin e parimit të barazisë dhe konkurrencës së ndershme duke u siguruar që të gjitha ofertat të trajtohen në mënyrë të njëjtë dhe të bazuar vetëm në kriteret e ligjshme dhe të dokumentuara në Dosjen e Tenderit. Shfuqizimin e çdo vendimi të ndërmarrë mbi bazën e kriterëve joekzistues ose të interpretuara gabimisht dhe garantimin që në këtë procedurë nuk do të përdoren më kriteret që nuk kanë mbështetje ligjore ose nënligjore. Ndërmarrjen e masave ligjore të parapara me ligj ndaj anëtarëve të komisionit vlerësues, zyrtarëve përgjegjës të Autoritetit Kontraktues që kanë lejuar dhe zbatuar këto shkelje, duke cënuar integritetin e procesit të prokurimit si dhe përjashtimin nga gara dhe futjen në listë të 63 zezë të të gjithë Grupit të Operatorëve Ekonomik të cilët kanë bërë deklaratime të rreme nën BETIM.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje për pretendimin e parë

OE ankues tenton të shtrembërojë dhe të krijojë konfuzion përmes shkresave duke cituar fillimisht se licenca për ekologë është e paligjshme, diskriminuese dhe e fabrikuar. Sqarojmë se ky pretendim është i pabazuar pasi që AK asnjëherë nuk ka pasur qëllim diskriminimin as favorizimin e asnjë OE. Ju vet keni kërkuar edhe informata shpesh në lidhje me dosjen e tenderit me datë 03.11.2024 dhe me datë 13.11.2024 keni pranuar përgjigjen nga AK, por as ju dhe asnjë OE tjetër nuk ka cekur që një licencë e tillë nuk ekziston. Të gjithë OE kanë pasur mundësi

ankese sipas nenit 108/A paragrafi 2, i cili përcakton se çdo ankesë për kushtet dhe kriteret e DT-së duhet të bëhet para afatit të dorëzimit të ofertave. Në këtë rast, asnjë GOE e as ju nuk e keni ushtruar këtë të drejtë, prandaj pretendimi është ligjërisht i papranueshëm, sepse në dosjen e tenderit është paraparë që eksperti ekolog duhet të posedojë licencë (referuar nenit 59.4 të LPP-së, ku thuhet se: “Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë kriteret e kualifikimit pas publikimit të njoftimit për kontratë”) dhe komisioni ka vlerësuar në bazë të kriterëve të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu, lidhur me këtë situatë GOE i rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarime të detajuara me datën 25.05.2025 për ekspertin në fjalë. Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar. Ju keni dorëzuar kontratën e punës me orar të rregullt për z. Murtez Kurtaj, e cila përmbush kriteret e nenit 9.1 & 9.2 për kapacitetin teknik dhe profesional në DT. Neni 59 i LPP-së parasheh se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime vetëm nëse dokumentacioni është i paqartë ose i paplotë. Në këtë rast, dokumenti ka qenë i qartë dhe nuk ka pasur nevojë për sqarim shtesë.

Përgjigje për pretendimin e dytë

Në përputhje me nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderit, ju njoftojmë se Komisioni vlerësues është themeluar nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë anëtarët e komisionit kanë marrë përgjegjësinë në vlerësimin e tyre duke respektuar kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin e kontratës. Pas përfundimit të punës, komisioni ka konstatuar se oferta e rekomanduar për kontratë është plotësisht e përgjegjshme dhe përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe paraqet çmim më të lirë se buxheti i parashikuar. Andaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Përgjigje për pretendimin e tretë

Sa i përket pretendimit se biznesi Samire Osmani BI është i shuar, sqarojmë se OE ka dhënë informacione shtesë lidhur me këtë pretendim si më poshtë: OE që më parë ishte i regjistruar si biznes individual Samire Osmani BI – 811044247 në emër të Samire Osmani, tashmë ka kaluar në formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k), me emrin Eko Lan Group Sh.p.k. me nr. 812244838, ku pronare e vetme është Samire Osmani. Ky ndryshim është kryer me datën 05.02.2025 dhe nuk përbën ndryshim të përmbajtjes së biznesit por vetëm të formës juridike. Si i tillë, ky është vazhdim i biznesit, siç e konfirmon edhe dokumenti zyrtar i lëshuar nga ARBK-ja. Pretendimi juaj është i pabazuar sepse neni 26 i LPP-së (“Grupi i operatorëve ekonomikë”) ndalon vetëm rastet kur një anëtar i grupit tërhiqet nga gara pas dorëzimit të ofertës. Në këtë rast nuk ka tërheqje, por vetëm ndryshim të formës juridike nga BI në Sh.P.K., gjë që nuk ndryshon identitetin ekonomik dhe kapacitetin teknik të OE-së. Ky ndryshim nuk është bazë ligjore për skualifikim automatik sipas LPP-së. Po ashtu, komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me kontratat dhe referencat. OE ka sjellë dëshmitë për të gjitha këto me datën 23.07.2025 duke sqaruar se të gjitha kontratat dhe referencat përmbushin kriterin në tërësi. Andaj pretendimi juaj se GOE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kushtin prej 950,000.00 euro është i pabazuar.

Përgjigje për pretendimin e katërt

Për listën e pajisjeve dhe mjeteve teknike të domosdoshme për realizimin e projektit, ky pretendim është i pabazuar, pasi që sqarimet nga GOE me datë 27.06.2025 e plotësojnë këtë kriter në tërësi sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Përgjigje për pretendimin e pestë

Sa i përket mungesës së planit për realizimin e projektit, GOE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar ofertën, planin dhe metodologjinë e detajuar për realizimin e projektit. Gjithashtu, ka ofruar edhe ditarin e shërbimeve me të gjitha detajet. Si rrjedhojë, GOE e ka plotësuar në tërësi kërkesën e AK dhe pretendimi është i pabazuar.

Përgjigje për pretendimin e gjashtë

Lidhur me diplomën dhe licencën e epidemiologes znj. Lebibe Hashani, sqarojmë se këto dokumente janë të noterizuara ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu, sa i përket përvojës së punës, kjo situatë është sqaruar me datën 28.04.2025. Andaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Si përfundim, AK qëndron mbresa raportit të vlerësimit të dorëzuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të caktuar nga AK (ZKA) si profesionistë dhe të cilët kanë vlerësuar në bazë të LPP-së neni 59 paragrafi 1 dhe RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), neni 40. Andaj, duke u bazuar në sa u tha më sipër, Autoriteti Kontraktues MBPZHR refuzon si të pabazë kërkesën për rishqyrtim të OE ankues “Doctor Exterminator DDD”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 21.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0798, ndërsa me datë 02.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0798, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0798 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës Shërbim, vlera totale e kontratës së parashikuar është 1,200.000.00€

AK me dt.03.10.2024 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt.22.11.2024, për këtë aktivitet prokurimi AK ka pranuar dy oferta në mesin e tyre edhe oferta e grupit të OE ankues.

Autoriteti Kontraktues – MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, pas ri-vlerësimit të ofertave me dt. 05.08.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë ka rekomanduar grupin e OE, Mburoja shpk & Samire Osmani; N.SH.H Zona Park; Vlora A. Ahmeti B.I; Efa Dienstleistung GmbH dega në Kosovë, vlera e ofertës 971,100.00€. Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar si ofertë të papërgjegjshme/eliminuar me arsyetimin se nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit sa i përketë stafit të kërkuar.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 08.08.2025 brenda afatit ligjor. AK me dt: 13.08.2025 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar, vlenë të ceket fakti se AK ka arsyetuar vendimin për secilin pretendim ankimor.

OE i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt: 20.08.2025 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Konstatimi 1

Pas ekzaminimit të shkresave, konstatoj se Autoriteti Kontraktues – MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për rivlerësim të ofertave të pranuar, konform rekomandimeve të Vendimit PSH; 2025/0127, dt.19.03.2025 të Panelit Shqyrtues të OSHP. Sipas Raportit, komisioni i rivlerësimit ka shqyrtuar dhe analizuar edhe njëherë ofertat duke kërkuar sqarime shtesë, nga të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi. Pas pranimit të përgjigjeve komisioni për ri-vlerësim, të ofertave ka rekomanduar për kontratë grupin e OE, Mburoya shpk & Samire Osmani; N.SH.H Zona Park; Vlora A. Ahmeti B.I; Efa Dienstleistung GmbH dega në Kosovë.

Konstatimi 2

Nga përmbajtja e ankesës së OE “Doctor Extraminator DDD SHPK, Ekologjia SHPK, Truly Nolen SHPK, vihet në pah insistimi se komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar në përputhje me nenin 59.par4 i LPP-së sepse sipas tyre, është rekomanduar për kontratë grupi i OE të papërgjegjshëm, ndërsa oferta jonë është eliminuar padrejtësisht me kriteret diskriminuese të cilat as ligji nuk i parasheh, shteti nuk i ofron dhe asnjë institucion publik nuk i ofron të ashtuquajturën Licencë Profesionale. Nga vet pretendimi ankimor vërehet se OE ankues nuk ka dorëzuar Licencën siç e ka cekur komisioni i vlerësimit në letren standarte për tenderuesin e eliminuar dhe se propozimi dhe kërkesa e tyre përfundimtare e dhënë në pikën përfundimtare të ngarkuar ndaras nga ankesa është që OSHP të nxjerr vendim të aprovohet ankesa dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ankesa, përfshin 1 pretendim që është trajtuar me Ekspertizën paraprake 2025/0127, (detajet i gjeni në konstatimet 3,)

Konstatimi 3

Është evidente se ky rast është gjykuar me një Vendim të OSHP-s nr PSH; 2025/0127, dt.19.03.2025 dhe se kundër veprimi i palës aktuale në ankesë prezanton përsëritje të problematikës së njëjtë, të cilën gjerësisht e kemi shqyrtuar në ekspertizën paraprake. Me këtë rast po rikujtojmë se pikërisht për këto lëshime të trajtuara me ekspertizën paraprake, ishin pajtuar të dy palët AK edhe OE ankues e që janë të konfirmuara me vendimin e përmendur të Panelit Shqyrtues, për pajtimin e palëve në kuadër të këtij vendimi është gjykuar si në vijim; Pas shqyrtimit të provave shkresore vlerësojmë se arsyet e eliminimit ndaj grupit të OE ankues për mungesë të dorëzimit të licencës Ekologu z. Murtez Kurtaj, siç është kërkuar në dosje të tenderit sepse nuk e ka përvojën e punës, Eksperti Shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit kishte kërkuar që: Min. një (1) Ekologë që ka njohuri të specializuara në identifikimin e llojeve të rriqrave dhe mjeteve të efektshme për të kontrolluar popullsinë e tyre. Minimum 2 vite përvojë pune. Grupi i OE të rekomanduar për kontratë, për ta përmbushur kërkesën e dosjes filen e emërtuar “11. EKOLOGJIA Shpk, dok. kërkesa 9.1&9.2 Stafit” , ku kishte bashkangjitur listën e stafit dhe me numër rendor 3 ishte z. Murtez Kurtaj, Ekolog me përvojë të punës 2017-2024, për të njëjtin kishte bashkangjitur CV-në, kontratën e punës të datës 01.03.2020, tek punëdhënësi

EKOLOGJIA me orar të plotë dhe pagë bruto prej 215.00€, diplomën e bachelor i biologjisë dhe diplomën master i biologjisë, dhe certifikatën e lëshuar nga NEHA (National Environmental Health Association) dhe EDC (Centres for Disease control and Prevention) përmes të cilës vërtetohet se z. Murtez Kurtaj ka marr pjesë në trajnim “ Biologji dhe kontrollin” por nuk ka ndonjë certifikatë apo licencë se i njëjti është certifikuar si njohës për identifikimin e llojeve të rriqërave siç është kërkuar në dosje të tenderit. Poashtu nëse e shohin CV-në e z. Murtez Kurtaj, vërehet se i njëjti ka përvijë në largimin e rriqërave. Citat nga CV-ja e dorëzuar me ofertë për z. Murtez Kurtaj “Si pjesë e eksperiencës sime profesionale, kam aplikuar njohuritë e mia të përgjithshme për menaxhimin e mjedisit dhe shëndetit publik në largimin praktik të rriqërave, zbatimin e teknikave profesionale për largimin e rriqërave duke përdorur produkte të specializuara për trajtime efikase, duke identifikuar dhe monitoruar zonat e prekura dhe duke kontribuar në zbatimin e masave parandaluese për kontrollin e tyre. Përvoja ime përfshin gjithashtu ndjekjen e standardeve të sigurisë dhe dokumentimin e trajtimeve të kryera”.

Eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin konkret komisioni i ri-vlerësimit, me dt. 23.4.2025 kishte kërkuar sqarime shtese nga ana e grupit te OE ankues, dhe pas pranimit të përgjigjes, ka konstatuar se z. Murtez Kurtaj nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit sepse nuk është dorëzuar licenca siç është kërkuar në dosje të tenderit. Poashtu, komisioni për rivlerësimin e ofertave ka konstatuar se kontrata e dorëzuar me ofertë për z. Kurtaj, parasheh që i njëjti është i angazhuar me orar të rregullt pune prej orës 8;00 deri 16;00 tek kompania Ekologjia shpk, kurse pas analizimit të listës se pagave në ATK-se të dorëzuar nga grupi i OE ankues pas kërkeses për sqarime me dt 17.04.2025 vërehet se i njëjti është i punësuar me punë sekondare apo jo te rregullt me q’rast, komisioni i rivlerësimit ka konstatuar se edhe kontrata e dorëzuar është e papranueshme për shkak se ka mospërputhje me listën e dorëzuar në ATK.

Siç vërehet nga pretendimi ankimor i OE ankues, nuk ka dorëzuar licencën për z. Kurtaj siç është kërkuar në dosje të tenderit, por ka dhënë një arsytim se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë diskriminuese dhe se një licencë e tillë nuk lëshohet nga organet e Republikës së Kosovë. Andaj vlerësojmë se në rastin konkret arsyeshmeria e dhënë nga ana e OE ankues se kërkesa e dosjes së tenderit është diskriminuese nuk qëndron, për faktin se OE ankues nuk kishte parashtruar ankese ndaj kritereve të dosjes së tenderit, për të kundërshtuar kriteret e dosjes se tenderit siç pretendon tani në ankesë.

Në këtë kontekst ne do të vazhdojmë ta shqyrtojmë si të vetmin arsytim valid atë që është ofruar nga Autoriteti Kontraktues, në letrën standarte për tenderuesin e eliminuar dhe vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pabazuar, lidhur me pretendimin ankimor se OE nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se OE ankues nuk ka dorëzuar Licencën dhe se kontrata e dorëzuar ka mospërputhje me listën e dorëzuar në ATK. Theksojm faktin se OE ankues ka dorëzuar ofertë, pa i kundërshtuar kriteret e paraqitura ne dosje te tenderit, madje njëherë është rekomanduar për kontratë por quditërisht nuk kishte pretendime ankimore se kërkesat e dosjes se tenderit ishin diskriminuese siç pretendon tani me ankesën e dorëzuar pranë OSHP-se.

Pa u thelluar mëtej, duket qartë se, dokumentet e dorëzuara nga ana e OE ankues, nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit në tërësin e saj siç është paraparë në (FTD) sepse përmbajnë mospërputhje sa i përket orarit të punës ne kontratë me listën e pagave të dorëzuar në ATK, kurse për Ekologun nuk ka dorëzuar fare licencë. Se çfarë në të vërtetë ka ndodhur, mbase do të mund të shpjegohej nga vetë operatori dhe AK (në rast të organizimit të ndonjë seance ballafaqimi në OSHP), por nga këndvështrimi ynë kjo situatë vlerësohet si mospërmbushje e

kërkesave të dosjes së tenderit nga ana e OE, ankues sa i përketë dëshmisë së kërkuar për stafin si Licenca dhe “Kontrata e punës”. Andaj në përputhje me konstatimet e më sipërme vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.

Sa i përpektë pretendimit tjetër se, AK ka bërë katër vlerësime dhe dy narrativa, ku fillimisht oferta e OE ankues ishte cilësuar si e përgjegjshme dhe e rekomanduar për kontratë kurse tani është eliminuar si ofertë e papërgjegjshme. Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në nenin 59 apargarfi 1 të LPP-se “ është kompetencë te AK-së, themelimi i komisionit për vlerësimin e ofertave, i cili ka për obligim të bëjë vlerësimin e ofertave bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe me pastaj ta përgatisin raportin e vlerësimit dhe rekomandimin përfundimtar. Neni 59 paragrafi 1 i LPP-se “Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”. Bazuar në platformën elektronike e-prokurimi raporti i vlerësimit është ngrit në platëformë me dt 05.08.2025, ne faqen 8 të raportit të vlerësimit tek kërkesa për stafin e kërkuar, komisioni ofertën e OE ankues e ka vlerësuar si ofertë të "papajtueshme" me kërkesat e dosjes së tenderit. Vlerësojmë se në rastin konkret, komisioni i vlerësimit në faqe 9 të raportit ka konstatuar se OE ankues është i papërgjegjshëm duke e arsyetuar edhe vendimin e tyre për eliminimin e ofertës së OE ankues. Poashtu eksperti shqyrtues sqaron se, mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të komisionit të vlerësimit respektivisht ZPP-së që të bëjë verifikimi e dëshmive të prezantuara me qëllim të vlerësimit të pretendimit ankimor dhe përmbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit. Mbi këtë bazë vlerësojmë se në rastin konkret pretendimi është pjesërisht i qëndrueshëm.

Sa i përpektë pretendimit tjetër se Operatori Ekonomik Samire Osmani B.i është biznes i shuar dhe se nuk duhet të merren për bazë dëshmitë e dorëzuara nga ky OE, AK në arsyeshmërinë e vendimit kur ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim si të pabazuar, ka potencuar faktin se OE me dt 05.02.2025 ka sqaruar se biznesi me numër 811044247, në emër të Samire Osmani, ka ndryshuar formën e juridike duke kaluar në Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar, me ç'rast ka marrë edhe emrin e ri "Eko Lan Group" Shpk. Poashtu AK përmes vendimit të datës 08.07.2025 kishte aprovuar si të bazuar pretendimin ankimor të OE tani i rekomanduar për kontratë sa i përketë ndryshimit të biznesit nga biznes individual në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin konkret komisioni i vlerësimit ka vepruar nëpërpunthje me nenin 59 dhe nenin 72 paragrafi 3 i LPP-se kur ka vlerësuar dokumentet e dorëzuara nga ana e OE Samire Osmani, se përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që ky OE ka ndryshuar vetëm statusin juridik nga Biznes Individual në Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe se nuk kemi të bëjmë me shuarje të biznesit siç pretendon tani OE ankues. Andaj në përputhje me konstatimet e më sipërme vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore, katër, pesë dhe gjashtë, eksperti shqyrtues sqaron se, AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim sqaron se lidhur me listën e pajisjeve dhe mjeteve të domosdoshme të kërkuara, kemi kërkuar sqarime shtesë me dt 27.06.2025 dhe se pas pranimit të përgjigjes nga ana e OE të rekomanduar, plotësohet në tërësi kërkesa e dosjes së tenderit, kurse për mungesë e planit dhe metodologjisë së punës AK ka sqaruar se OE i rekomanduar me ofertë ka dorëzuar planin dhe metodologjin e detajuar për realizimin e projektit si dhe ditarin e shërbimeve me të gjitha detajet. Kurse sa i përketë pretendimit ankimor, lidhur me licencën e epidemiologes znj. Habibe Hashani, AK, ka sqaruar se dokumentet e dorëzuara janë të noterizuara ashtu siç janë kërkuar në dosje të tenderit. Gjithëashtu sa i përketë, përvojës së punës, këtë situatë AK e ka sqaruar sipas kërkesës së datës 28.04.2025 dhe pas sqarimeve, ka konstatuar se plotëson kërkesën e dosjes së tërësi. Eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin

konkret, AK në dosje të tenderit nuk kishte kërkuar që diplomat të jenë të nostifikuara siç pretendon tani OE ankues por kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë vetëm që diploma të jetë e noterizuar “OE për stafin profesional duhet të dëshmoj me diplomë të noterizuar” ndërsa sa i përketë faturave të kontestuara nga OE ankues për pajisjet e dorëzuara apo më saktësisht fatura 13, e cila përmbanë përshkrimin “ Automikser ULV Gjenerator Multifunksional elektromagnetik HD 100”, sqarojm se fatura në fjalë është e nënshkruar dhe vulosur si nga shitësi ADIS-B dhe blerësi Samire Osmani, si e tillë e përbushë kërkesën e dosjes së tenderit, kurse sa i përketë pretendimit se fatura është fiktive OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi përmes të cilës vërtetohet pretendimi ankimor në mungës të kësaj ne do të vazhdojmë ta shqyrtojmë si të vetmin arsyetim valid atë që është ofruar nga Autoriteti Kontraktues në raportin e vlerësimit dhe arsyeshmerinë e dhënë në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si te pabazuar nga AK. Poashtu eksperti shqyrtues sqaron se, në rast se komisioni i vlerësimit ka pasur dyshime për ndonjë dëshmi të dorëzuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë kanë mundur që konform nenit 52 paragrafi 7 i LPP-se për cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit”. Bazuar në platformen elektronike e-prokurimi, komisioni i vlerësimit nuk e ka bërë një gjë të tillë, edhe përkundër faktit se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar fatura fiktive. Në rastin konkret, vlerësoj se mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të komisionit të vlerësimit respektivisht ZPP-së që të bëjë verifikimi e dëshmive të prezantuara me qëllim të vlerësimit të pretendimit ankimor dhe përmbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit, dhe se “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”.

Pa u thelluar mëtej, duket qartë se, komisioni i vlerësimit- respektivisht ZPP-ja ka vepruar në përputhje me vendimin e PSH; 2025/0127, duke kërkuar sqarime shtesë, pas pranimi të dëshmive ka konstatuar se grupi i OE të rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar dëshmi të vlefshme lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit, për pajisjet e kërkuara, përvojën e punës së stafit dhe për statusin e biznesit Samire Osmani. Pas sqarimit të këtyre dilemave komisioni i rivlerësimit respektivisht ZPP-ja, vendos t'i pranojë si te vlefshme sqarimet dhe dëshmitë e pranuar nga ana e grupi të OE të rekomanduar për kontratë sa i përketë përvojës së epidemiologes znj Habibe Hashani, faturat e pajisjeve të kërkuara dhe ndërrimin e statusit të biznesit nga individual në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Andaj, vlerësojmë se në rastin konkret, komisioni për ri- vlerësimin e ofertave ka vepruar në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe vendimin e PSH; 2025/0127, dt.19.03.2025 kur ka kërkuar sqarime shtese dhe pas pranimi të sqarimeve shtesë, pas disa ri-vlerësimeve janë bindur se ofertat e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, me të vertetë i plotësonë kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosjes të tenderi. Andaj në përputhje me konstatimet e më sipërme vlerësojmë se pretendimet katër, pesë dhe gjashtë të palës në ankesë janë të paqenëdrueshëm.

Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se bazuar në nenin 17.15 të rregullores për prokurimin publik nr 001/22, vendosja e kritereve të përzgjedhjes është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vendosja e kritereve të bëhet në harmoni të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi i hapësirave të ekspozuara për Ethe hemorragjike Krime Kongo” me numër të prokurimit 203-24-10403-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I, dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: